



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Raporti vjetor i punës dhe i performancës të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2022

**Raporti vjetor i punës dhe i
performancës të Akademisë së Drejtësisë
për vitin 2022**

©Akademia e Drejtësisë 2022.
Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e
këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme
tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim
të Akademisë së Drejtësisë.

Raporti vjetor i punës dhe i performancës të Akademisë së Drejtësisë
është miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë me datën 28.03.2023



TABELA E PËRMBAJTJES	2
Fjala hyrëse	7
1. Përmbledhje ekzekutive	9
2. Mandati i Akademisë së Drejtësisë	10
2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë	11
2.2 Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese	11
2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit të saj	12
2.4 Funksionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë	12
3. Organet e Akademisë së Drejtësisë	13
3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra.....	13
Aktivitetet e Këshillit Drejtues	14
3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra	15
Aktivitetet e Këshillit Programor	16
3.3 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë	16
3.3.1 Drejtori Ekzekutiv – Mandati dhe aktivitetet e ndërmarra.....	17
Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv.....	17
3.3.2 Zyra e Programeve Trajnuese- Departamentet e AD-së	18
4. Të arriturat dhe sfidat në zbatimin e Planit të Punës dhe të Performancës si dhe Programit Trajnues 2022	18
4.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2022	20
4.2 Të arriturat në zbatimin e programit trajnues 2022.....	21
4.3 Krahësimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit	23
4.4 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë	24
5. Aktivitetet trajnuese dhe aktivitetet e tjera realizuara sipas programeve të AD-së.....	28
5.1 AFTËSIMI I GJYQTARËVE/PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR DHE PËRGATITJA PROFESIONALE PËRSHTATSHMËRISHT ME ROLIN DHE DETYRAT E FUNKSIONIT PËRKATËS (PROGRAMI I TRAJNIMIT FILLESTAR)	28
5.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Programin e Trajnimit Fillestar dhe Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2022	29
5.1.2 Zbatimi i trajnimit fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar gjatë vitit 2022	30
Zbatimi i trajnimit praktik për gjeneratën e tetë të gjyqtarëve të sapo emëruar (2021-2022).....	30
5.1.3 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve për gjeneratën e VIII të 24 gjyqtarëve të sapo emëruar në fushën hulumtuese dhe qasjen në burime ligjore	30

5.2 AVANCIMI I VAZHDUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONSTËVE TJERË LIGJOR NË SHKATHTËSITË	34
5.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2022	34
5.2.2 Aktivitetet trajnuese në PTV	34
5.2.4 Zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve..	39
5.2.5 Trajnimet e vazhdueshme në fushën penale (materiale dhe procedurale).....	41
5.2.6 Trajnimet nga fusha Komerciale	42
5.2.7 Trajnimet nga E Drejta Kushtetuese	43
5.2.8 Trajnimet për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme	43
5.2.9 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve	43
5.2.10 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe BE-së	44
5.2.11 Trajnimet nga fusha e ndërmjetësimit	45
5.2.13 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes trajnimeve dhe tryezave në fushën civile.....	46
5.2.14 Tryezat dhe trajnimet nga Drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal	46
5.2.15 Trajnimet dhe tryezat nga fusha Administrative	47
5.2.16 Zbatimi i trajnimeve interdisiplinare për gjyqtarë dhe prokurorë	48
5.2.17 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	48
.....	49
5.2.19 Bashkëpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e Trajnimeve të Vazhdueshme	49
5.2.20 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.....	50
5.2.21 Trajnimet për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive	51
5.2.22 Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesioneve të lira –	52
Zbatimi i trajnimeve për profesionet e lira.....	52
5.2.23 AVANCIMI I METODOLOGJISË TRAJNUESE SIPAS STANDARDEVE DHE METODAVE BASHKËKOHORE-TRAJNIMET PËR TRAJNUES	53
Zhvillimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë	53
Zbatimi i trajnimit për trajnues	53
5.2.24. Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	55
6. RRITJA E CILËSISË SË PROGRAMEVE TRAJNUESE, KAPACITETEVE ANALITIKE DHE HULUMTUESE SI DHE VEPRIMTARISË BOTUESE -PROGRAMI PËR HULUMTIME DHE PUBLIKIME.....	56

6.1. Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues për vitin 2023	56
6.2 Zhvillimi i veprimtarisë botuese	57
6.3 Pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, analiza e bazës së të dhënave dhe ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së	58
6.4 Përditësimi i statistikave dhe data bazës së të dhënave me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së.....	59
7. AVANCIMI DHE ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT DHE KOORDINIMIT ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE	60
7.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës	60
7.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë	60
7.3 Zbatimi i projekteve me donatorë	60
Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së OPDAT dhe Ambasadën Amerikane.....	61
Aktivitetet e realizuara me Projektin për Drejtësi Kormeciale të mbështetura nga USAID	61
Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj	61
Aktivitetet me Bankën Botërore - Projektin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO)	62
Aktivitetet e realizuara me zyrën e Këshillit të Evropës dhe projektet e saj.....	62
Aktivitetet e realizuara me iniciativën e Chemonics për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), financuar nga Mbretëria e Bashkuar.....	62
Aktivitetet e realizuara me OSBE-në.....	62
Aktivitetet e realizuara me GIZ	63
Aktivitetet e realizuara me UNDP	63
Aktivitetet e realizuara me UNCHR-Zyra e Misionit në Kosovë.....	63
Aktivitetet e realizuara me Humanitarian Law Center dhe organizat tjera si INJECT, Qendra Kosovare për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës (KRCT) dhe Qendra Kosovare për studime gjonore	63
Aktivitetet e realizuara me Shkollën e Magjistraturës së Shipërisë	64
Aktivitetet e realizuara me EULEX	64
Aktivitetet me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)	64
Programet praktike dhe shkëmbimi i përvojave me vendet në rajon	65
7.4 Planifikimi institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese	66
Aktivitetet në mbështetje të mekanizmave integrues për BE.....	66
8. TRANSPARENË DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN.....	67

9. ZBATIMI I POLITIKAVE ZHVILLIMORE TË DEPARTAMENTIT PËR ADMINISTRATË DHE FINANCA PËR MBËSHTETJEN E PROGRAMEVE TRAJNUESE DHE AKTIVITETEVE TJERA SIPAS LIGJIT NË FUQI	67
9.1 Shërbimet e përgjithshme	68
9.2 Zhvillimi, menaxhimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore	68
9.2.1 Të punësuarit dhe nevojat për punëtorë të rinj	68
9.2.2 Trajnimet e stafit	70
9.3 Avancimi i teknologjisë informative	70
9.4 Prokurimi	71
9.5 Financat	72
9.6 Mbështetja financiare nga donatorët	77
9.7 Asetet	78
9.7.1 Asetet e Akademisë	78
9.7.2 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë	79
9.8 Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	79
10. Sfidat dhe rekomandimet	79
Anekset	86

Akronimet

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ANJF - Agjencioni për Ndihmë Juridike Falas

DAF – Departamenti i Administratës dhe Financave

DHPGJS-Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

EIFL - Electronic Information for Libraries

EJTN – European Judicial Training Network (Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor)

ENM – L'École Nationale de la Magistrature

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

IGJK – Instituti Gjyqësor i Kosovës

ILIAS – Integriertes Lern – Informations - und Arbeitskooperations-System

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPMShCK – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

KPPK – Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

LMD – Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OPP - Oda e Përmbauesve Privat

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

SQEPK-Sistemi qendror i evidencës Penale të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

UNDP-Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNHCR-Zyra e Misionit në Kosovë

ZKA – Zyra e Kombëtare e Auditimit

Fjala hyrëse

Raporti i punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2022 shfaqë aktivitetet trajnuese dhe aktivitetet tjera të cilat janë realizuar në këtë periudhë në funksion të zhvillimit profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Të gjitha aktivitetet trajnuese deri në fund të muajit mars janë realizuar online si rrjedhojë e kufizimeve të imponuara nga Pandemia COVID 19, ndërkaq nga muaji prill e deri në fund të vitit me pjesëmarrje fizike sipas standardeve bashkëkohore të trajnimit gjyqësor.

Raporti në detaje ofron trajnimet e realizuara në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë, trajnimet fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar, për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe trajnimet për profesionistët e tjerë ligjor.

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar trajnime që kanë përfshirë kompetencat sipas departamenteve të gjykatave dhe prokurorive përshtatshëm me nevojat trajnuese. Përveq kësaj janë ofruar edhe trajnime të specializuara në fushat specifike si për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, shpëlarjes së parave, hetimit financiar, mashtrimit në prokurimin publik, pastaj trajnime për mbrojtjen nga dhuna në familje, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, të cilat ishin si rezultat i nevojave trajnuese të vet gjyqtarëve dhe prokurorëve por edhe prioritet nacional në bazë të dokumenteve strategjike të vendit si edhe nga vlerësimet dhe rekomandimet e raportit të BE-së për Kosovën.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare janë realizuar sesionet e trajnimit praktik dhe me këtë edhe përmbushja e progamit trajnues për 24 gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VIII. Pastaj trajnimi teorik për 48 të gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e IX, konform programit trajnues për këtë gjeneratë si dhe sesionet e trajnimit teorik dhe praktik për 6 prokurorët e sapo emëruar, të cilët poashtu përkojnë me gjeneratën e IX të prokurorëve në Programin Fillestar të Akademisë së Drejtësisë. Programi trajnues për të dy profilet do të vazhdojë edhe në vitin 2023 meqë programi ka filluar në korrik të vitit 2022¹.

Për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor janë realizuar trajnimet nga modulet e trajnimit bazik aspekti penal material dhe procedural, ndërkaq për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive janë realizuar aktivitete trajnuese të cilat kanë qenë përshtatshëm me funksionin dhe detyrat e punës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimeve për etiken, komunikimin, menaxhimin e dosjeve etj.

Trajnuesit janë faktorë kyq në zbatimin e programeve trajnuese dhe në këtë vështrim AD vëmendje të veçantë i ka kushtuar fuqizimit të kapaciteteve trajnuese veçanërisht duke realizuar Trajnime për Trajnues për krimin kibernetik, terrorizmin, për dhunën në familje, për ndërmjetësimin, mbrojtjen e sinjalizuesve. Këto trajnime i kanë vijuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të ndryshëm ligjor.

Në raport në detaje janë aktivitetet të cilat janë realizuar me buxhetin e AD-së dhe një pjesë e konsiderueshme me mbështetjen financiare të donatorëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të AD-së.

¹ Numri prej 24, 48 dhe 6 nënkupton të dekretuarit për pozitat përkatëse dhe nuk asocion deri në fund edhe me numrin e vijuesve, veçanërisht për gjeneratën e IX, përkatësisht te gjyqtarët.

Në kuadrin e hulumtimeve dhe publikimeve janë realizuar aktivitete në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programeve trajnuese si dhe aktivitete tjera në fushën e publikimeve.

Në kuadrin e trajnimeve për profesionet e lira janë realizuar trajnime për përmbaruesit privat, zyrtarët e ndihmës juridike falas si dhe për mbrojtësit e viktimave. Përveq kësaj avokatëve shtetëror si dhe profesionistëve tjerë ligjor i është mundësuar pjesëmarrja në trajnime të vazhdueshme bashkë me gjyqtarë dhe prokurorë në tematikat për të cilat kanë shfaqur interes këta profesionistë.

Në vazhdim raporti vjetor i punës përmban edhe të dhëna për shpenzimet buxhetore dhe aktivitetet e prokurimit në kuadër të Departamentit për Administratë dhe Financa.

Në fund shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë duke filluar nga Keshilli Drejtues, Keshilli Programor, trajnuesit, stafin, miqtë dhe bashkëpunëtorët e Akademisë për përkushtimin dhe angazhimin maksimal në zbatimin e gjithë këtyre aktiviteteve që janë në funksion të rritjes së kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Sinqerisht,
Vaton Durguti
Kryetar i Këshillit Drejtues

1. Përmbledhje ekzekutive

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë nëpërmes programeve trajnuese dhe ofrimit të burimeve ligjore në vazhdimësi është angazhuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqarëve, prokurorëve dhe përfituesve të saj sipas ligjit. Programet e trajnimit janë zhvilluar dhe dizajnuar në bazë të vlerësimit të nevojave trajnuese duke përfshirë edhe kërkesat specifike dhe prioritetet e KGJK-së dhe KPK-së, Strategjisë për sundimin e ligjit dhe strategjitë tjera që ndërlidhen dhe ndikonë në punën e gjyqësorit si dhe të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Përmbajtja e programeve si në trajnimet e vazhdueshme që i dedikohen gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, ashtu edhe në trajnimet fillestare që i dedikohen gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar në këto funksione ishte gjithëpërfshirëse duke përfshirë gjitha fushat e së drejtës.

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme përveq trajnime të specializuara për krimin e organizuar dhe korrupsionin si dhe veprat tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, vëmendje të veçantë kanë pasur edhe trajnimet për risitë e Kodit të Procedurës Penale, tryezat për unifikimin e praktikës gjyqësore në fushën penale, civile administrative të cilat janë konfirmuar nga vet përfituesit e tyre se janë shumë më efektive dhe për më tepër adresojnë sfidat dhe vështirësitë praktike. Në trajnimet e vazhdueshme kanë marrë pjesë gjyqtarë prokuror dhe sipas tematikës edhe profesionistë tjerë ligjor si zyrtarë policor, zyrtarë doganor, nga njësia e inteligjencës financiare, avokatë etj.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare është përfunduar me sukses programi trajnues për 24 gjyqtarë të cilët trajnimin fillestar e kanë filluar gjatë vitit 2021 si dhe është filluar programi trajnues për 48 gjyqtarë dhe 6 prokurorë të rinj. Me kërkesën e KGJK-së trajnimi fillestar për gjyqtarë është filluar së zbatuari intenzivisht 5 ditë të javës me sesionet e trajnimit teorik në të gjitha modulet trajnuese për të vazhduar me tutje me sesionet e trajnimit praktik gjatë vitit 2023 në gjykatat përkatëse të emërimit. Trajnimi fillestar për prokuror është filluar së zbatuari paralelisht sesionet e trajnimit teorik 2 ditë në javë ndërkaq 3 ditë tjera të javës me sesionet e trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit. Trajnimet fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e rinj pritet të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2023 meqë trajnimet zgasin 12 muaj, ndërkaq trajnimi për këto kategori ka filluar në korrik të vitit 2022.

Gjithashtu, përfitues të programeve të AD-së sipas ligjit janë edhe bashkëpunëtorët profesional si dhe stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive. Gjatë këtij viti janë zbatuar veçanërisht trajnimet për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të cilit në periudhën raportuese kanë vijuar sesionet e trajnimit nga moduli bazik penal material dhe procedural për të vazhduar në vitin në vijim edhe me aspektin civil. Bashkëpunëtorët profesional poashtu kanë vijuar trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjatë periudhës raportuese AD ka organizuar trajnime edhe për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive duke iu dedikuar profileve të caktuara si administratorëve, ndihmës administratorëve, shëfave të zyrës për menaxhimin e lëndëve, arkivistëve etj. Raporti përfshinë edhe aktivitetet tjera dedikuara profesionistëve tjerë duke përfshirë përmbartuesit privat, zyrtarëve të ANJF, avokatët shtetëror, mbrojtës ve të viktimave etj.

Për zbatimin e trajnimeve janë angazhuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor me përvojë dhe gjithashtu edhe ekspert ndërkombëtarë të cilët kanë ofruar praktikën më të mira gjyqësore në çështjet penale, civile, komerciale administrative, dhe posaqërisht në drejtësinë për fëmijë dhe në përgjithësi në fushën e të drejtave të njeriut.

Raporti në detaje ofron trajnimet që janë realizuar për secilën kategori duke përfshirë edhe numrin e pjesëmarrësve, përkatësisht të trajnuave.

Në raport janë paraqitur edhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve të trajnuesve për fushën e krimit kibernetik, terrorizmin, dhunën në familje, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe në çështjet e ndërmjetësimit.

Burimet ligjore kanë vazhduar të jenë në shërbim të përfituesve të AD-së, veçanërisht formatet elektronike dhe burime ligjore ndërkombëtare përmes ABEK.

Akademia suksesshëm është përfaqësuar në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare, ndërkaq ndihmë të madhe ka dhënë në fasilitimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve, prokurorëve në trajnime në institucione të ndryshme të trajnimit gjyqësor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar të cilat për qëllim kishin zhvillimin profesional të tyre.

Si çdo vit edhe gjatë vitit 2022 nuk ka munguar mbështetja nga donatorë dhe partnerë tjerë të cilët kanë asistuar në vlerësimin e nevojave trajnuese, në hartimin e programeve dhe zbatimin e tyre. Përmes ekspertizës së tyre ndërkombëtare kanë promovuar praktikën më të mira në luftimin dhe parandalimin e formave të ndryshme të kriminalitetit.

Raporti përmbanë edhe aktivitetet në menaxhimin dhe ekzekutimin adekuat të buxhetit të Akademisë së Drejtësisë për zbatimin e drejtë të veprimtarisë së saj me ligj dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në drejtim të zhvillimit dhe aftësisht profesional të gjyqtarëve, prokurorëve dhe komunitetit tjetër ligjor që janë përfitues sipas ligjit të AD-së.

2. Mandati i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë është institucion publik, i pavarur cili është në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionet e lira. Akademia e Drejtësisë këtë funksion e realizon përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe burimeve ligjore në përputhje me nevojat adekuate për trajnime të cilat identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese. Akademia e Drejtësisë kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

Misioni

Të ofrojë trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

Vizioni

Të shërbejë si institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për AD-në, ndërsa nga shtatori 2022 dhe të Ligjit nr. 08/L-063, kapitulli IV për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe aktet nënligjore të përcaktuara si në vijim:

Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;

Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;

Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;

Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;

Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesione të Tjera të Lira;

Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;

Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;

Rregullorja Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.

Rregullorja Nr. 02/2019 - për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë

Rregullorja Nr. 01/2019 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë;

Rregullore Nr. 01/2020, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar.

2.2 Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Gjatë vitit 2022 është përfunduar procesi për organizimin dhe funksionimin më të mirë të administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura duke sjellë *Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura*. Ky ligj përfshinë edhe Akademinë e Drejtësisë, përmes të cilit ruhet edhe më tej pavarësia institucionale e Akademisë së Drejtësisë duke vënë mbikëqyrjen e Akademisë së Drejtësisë nga Këshilli Drejtues i saj.

Po ashtu në periudhën raportuese është punuar në draft protokollin me KPK për trajnimet e detyrueshme për prokurorët me mandat të përhershëm dhe i njëjti është finalizuar dhe miratuar nga AD dhe KPK dhe pritët të zbatohet në rastin e kërkesave që dalin pas vlerësimit të performancës së prokurorëve. Ngjashëm pritët të veprohet edhe me KGJK-në për trajnimet e detyrueshme për gjyqtarë. Gjithashtu Rregullorja aktuale për Trajnuesit dhe Mentorët ka kaluar në

disa faza të rishikimit të saj, veçanërisht rreth fuqizimit edhe më tej të kriterëve të përzgjedhjes së trajnuesve dhe mentorëve. Pritet finalizimi i saj dhe vënia në funksion me rastin e rekrutimit të trajnuesve dhe angazhimit të tyre për zbatimin e programeve trajnuese.

2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit të saj

Gjatë zbatimit të Ligjit të AD-së në praktikë janë vënë në pah vështirësi të theksuara të cilat kanë ndikuar në përmbushjen e misionit të saj. Ligji nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, përkatësisht neni 19 si dhe *Ligji nr. 06/L - 054 për Gjykatat*, përkatësisht neni 31 të cilat i dedikohen trajnimit fillestar përcaktojnë si të obligueshme trajnimet fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar me kohëzgjatje 12 muaj dhe përbëhet nga pjesa teorike dhe praktike. Këshilli Gjyqësor i Kosovës në anën tjetër duke vlerësuar ngarkesën me lëndë nëpër gjykata ka vendosur që edhe gjyqtarët e sapo emëruar të vendosin një sasi të konsiderueshme të lëndëve të lehta. Kjo situatë ka rrezikuar përmbushjen e programit trajnues fillestar konform Ligjit të AD-së meqenëse në disa raste gjyqtarët nuk kanë ndjekur sesionet e trajnimeve për të proceduar me lëndët sipas ngarkesës.

Plotësim, ndryshimi i Ligjit nr. nr. 05/L-095, respektivisht *Ligji nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura*, ka zgjidhur një dilemë të madhe dhe të kahmotshme lidhur me statusin dhe vijën llogaridhënëse të AD-së. Bazuar në këtë ligj, Akademia e Drejtësisë mbetet dhe është institucion publik që për punën e saj i raporton Këshillit Drejtues të AD-së. Përderisa me këtë ligj vazhdon të ketë statusin e institucionit të pavarur, pritjet e Akademisë së Drejtësisë janë të adresohen edhe pengesat ligjore që ka pasur dhe në plotni të ushtroj veprimtarinë e saj. Megjithatë edhe më tej përcaktimi i akteve nënligjore decidivisht me Ligji nr. 05/L-095 pamundësohet nxjerrja e akteve nënligjore që janë të nevojshme edhe për trajnimet e vazhdueshme si dhe në sferën e publikimeve të AD-së.

Në koncept dokumentin që është në proces të Ministrisë së Drejtësisë për Ligjin për Akademinë e Drejtësisë janë ofruar çështjet ligjore që duhet të adresohen dhe të përfshihen në plotësim ndryshim të ligjit aktual apo edhe në hartimin e ligjit të ri. Në grupin punues janë të përfaqësuar të gjitha institucionet relevante si AD, KGJK, KPK, MD, Shoqeria Civile si dhe ekspertet nderkombetare nga EUKOJUST dhe OPDAT.

2.4 Funksionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë


Bazuar në kompetencat që përcakton ligji, Akademia e Drejtësisë kryen funksionet e parapara si në vijim:

- a. harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- b. zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuara nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK).

- c. organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- d. mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;
- e. zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- f. mbanë të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- g. vendosë dhe mbanë bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- h. kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- i. kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- j. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

3. Organet e Akademisë së Drejtësisë

Kompetencat dhe funksionin e saj AD i kryen përmes organeve kryesore të saj si Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv.



Grafikoni nr. 1

3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Drejtues i Akademisë përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë nga institucionet e mëposhtme:

Anëtarë ex officio janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit. Anëtarët tjerë janë:

- a. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së;
- b. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së;
- c. 1 (një) anëtarë i emëruar nga Ministria e Drejtësisë;

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite, pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

Sipas ligjit, Këshilli Drejtues i Akademisë ka kompetencë për:

- a. Miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- b. Miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- c. Miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- d. Miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- e. Mbikëqyrjen e punës së Akademisë;
- f. Përcaktimin e prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- g. Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- h. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- i. Kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore;

Aktivitetet e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues ka ushtruar me sukses mbikëqyrjen e punës së AD së. Në periudhën raportuese janë realizuar gjithsejt tetë (8) takime. Në pajtim me mandatin e tij ka nxjerrë vendime të cilat kanë avancuar edhe më tej punën e AD-së, ka diskutuar dhe ka aprovuar programet trajnuese, raportin vjetor të punës, planin e punës së AD-së dhe ka vendosur për çështje të ndryshme që ndërlidhen me punën dhe aktivitetet e AD-së.

Për më hollësisht në vijim janë çështjet më kryesore për të cilat ka vendosur gjatë vitit:

1. Formimin e një mekanizmi koordinues që do të shërbej në avancimin dhe koordinimin e aktiviteteve të dala nga Plan i veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026, të cilat ndërlidhen në mes të Akademisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës;
2. Formimin e komisionit të veçantë për vlerësimin e punimeve hulumtuese në trajnimin fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar-gjenerata VIII, i cili përbëhet nga trajnuesit e trajnimit

- filleshtar për gjyqtarët e sapoemëruar – gjenerata VIII, të cilët e mbulojnë fushën ku janë përzgjedh punimet hulumtuese nga gjyqtarët e sapoemëruar. Kompensimi i anëtarëve të këtij komisioni të jetë barasvlershëm me kompensimin e trajnuesve të përkohshëm për një ditë trajnimi;
3. Miratimin e Programit Trajnues për prokurorët e sapoemëruar – gjenerata e 9 me rekomandimet e Këshillit Programor;
 4. Miratimin e Programit Trajnues për gjyqtarët e sapoemëruar – gjenerata e VIII-lista e moduleve, me rekomandimet e Këshillit Programor dhe të Këshillit Drejtues, si dhe aprovoi ndryshimin e pikës 1. Programi Trajnues për prokurorët e sapoemëruar – gjenerata e 9 sipas rekomandimeve të Këshillit Drejtues;
 5. Miratimin e Raportit Vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2021
 6. Vendimin për fillimin e zhvillimit të trajnimeve me pjesëmarrje në mënyrë fizike në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme
 7. Miratimin e listës për trajnuesit e certifikuar në fushën e të Drejtës Komerciale, për t'u përfshirë të njëjtit si trajnues të përkohshëm në Akademinë e Drejtësisë
 8. Amandamentimin e Programit Trajnues për prokurorët e sapoemëruar – gjenerata e 9.
 9. Miratimin e Kërkesës buxhetore
 10. Miratimin e kërkesës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për fillimin e trajnimit filleshtar për prokurorët e dekretuar gjenerata e IX, si dhe propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës për Mentorët që do të angazhohen për të mentoruar prokurorët e sapoemëruar;
 11. Ka zhvilluar dhe suksesshëm ka përmbyllë procesin për vlerësimin e performancës së Drejtorit Ekzekutiv dhe ka vazhduar pozitën e Drejtorit Ekzekutiv aktual dhe për një mandat;
 12. Amandamentimin e Programit Trajnues të AD-së, për vitin 2022, me temat e propozuara rreth risive të Kodit të Procedurës Penale;
 13. Miratimin e Programit Trajnues për vitin 2023;
 14. Miratimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2023;
 15. Miratimin për ndryshimin e rregulloreve për Këshillin Drejtues, Këshillin Programor, Drejtorin, Trajnues dhe mentor, Kompensimin e trajnuesve dhe mentorëve dhe Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AD;
 16. Aprovuar parimisht pro Protokolit për trajnime të detyrueshme të prokurorëve përe pikat e rënditura në nenin 8 të protokolit për obligimet e AD-së.

3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Programor është organ ndihmës profesional i cili angazhohet për hartimin e Programit të Trajnimeve dhe për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga Akademia e Drejtësisë. Funksionet kryesore të Këshillit Programor janë:

- Hartimi i propozim programit të trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Përcjellja e realizimit të programeve dhe sukseseve të tyre;
- Të jap orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;

Të jap mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
 Të jap këshilla propozime dhe sygjerrime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
 Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Këshilli Programor përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Aktivitetet e Këshillit Programor

Në periudhën raportuese, Këshilli Programor konform mandatit ligjor është angazhuar intenzivisht në përcaktimin e kurruklës trajnuese të AD-së duke pas në konsideratë gjetjet nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese dhe kërkesat nga dokumentet strategjike të vendit. Në përbërje të plotë ka ushtruar me sukses funksionin e tij në hartimin në përgjithësi të Programit trajnues 2023 dhe aktivitete tjera sipas mandatit.

Në bashkëpunim me KGJK, KPK, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive ka hartuar programet trajnuese për vitin 2023 për trajnimet e vazhdueshme dhe trajnimet fillestare dhe të njëjtat i ka rekomanduar Këshillit Drejtues për miratim.

Gjatë kësaj periudhe ka realizuar 4 takime, prej tyre një (1) takim në të cilin ka shqyrtuar Draft Programin Fillestar për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e IX, plotësim ndryshimin e Rregullores nr. 02/2019 për trajnues dhe mentorë dhe listën e trajnuesve të certifikuar për trajnime të gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale për ta përfshirë në listën e trajnuesve të përkohshëm të AD-së. Takimi i radhës ishte një (1) me takim bashkë me Kryetarë të Gjykatave dhe një (1) takim me Kryeprokuror të Prokurorive për të shqyrtuar gjetjet nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë. Pas këtyre takimeve për disa ditë me radhë është angazhuar në hartimin e koncepteve të trajnimit sipas fushave dhe në takimin e përbashkët të radhës (1) ka shqyrtuar përfundimisht draftin e Programit dhe ka rekomanduar për diskutim dhe miratim në Këshillin Drejtues.

3.3 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë

Në kuadrin e Akademisë së Drejtësisë janë të punësuar 25 zyrtarë duke përfshirë edhe Drejtorin Ekzekutiv ndërkaq janë të lejuara gjithësejt 32 pozita. Në periudhën raportuese nuk është zhvilluar asnjë procedurë e rekrutimit për pozitat e lira për shkak të ndryshimeve legjislative përkatësisht Ligji për zyrtarët publik por edhe nismat për ndryshimin e Ligjit për AD-në.

Organizimi i brendshëm është i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë, ku sipas kësaj

rregulloreje, Akademia e Drejtësisë është e ndarë në katër departamente dhe zyrën e programeve trajnuese.

Bazuar në aktin për organizimin e brendshëm², Akademia e Drejtësisë funksionon dhe është e organizuar me këtë strukturë:

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
 Departamenti për Trajnim Fillestar,
 Departamenti për Trajnim të Vazhdueshëm,
 Departamenti për Hulumtime dhe Publikime si dhe
 Departamenti për Administratë dhe Financa

3.3.1 Drejtori Ekzekutiv – Mandati dhe aktivitetet e ndërmarra

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, Drejtori Ekzekutiv bën pjesë në kategorinë e Zyrtarëve të Lartë Drejtues. Gjatë vitit 2022 është fokusuar në realizimin e aktiviteteve si në vijim:

- a. Përfaqësimin e Akademisë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- b. Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- c. Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- d. Propozimin e projektbuxhetit vjetor të Akademisë;
- e. Propozimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2023 dhe Programin e Trajnimeve për vitin 2023;
- f. Propozimin e listës së trajnuesve për miratim nga Këshilli Drejtues;
- g. Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- h. Përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve tjera sipas kërkesave të Këshillit Drejtues.

Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv

Në pajtim me funksionin e tij, aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë kanë qenë të orientuara në drejtim të funksionimit më të mirë të punës së AD-së.

Bazuar në kalendarin e aktiviteteve të zyrës së drejtorit janë realizuar mbi 324 aktivitete të ndryshme, në kuadër të cilave ka pasur takime koordinuese me krerë të institucioneve të sistemit të drejtësisë, aktivitete në kuadër të planifikimit dhe organizimit të punës për zbatimin e trajnimeve, takime me përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që mbështesin punën e AD-së, të gjykatave dhe prokurorive. Pjesë e konsiderueshme e angazhimit janë edhe raportimet para komisioneve të ndryshme të kuvendit për punën e AD-së. Ka marrë pjesë në punëtori dhe konferenca të ndryshme në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë. Është angazhuar në punën e përbashkët me Këshillin Programor si dhe është kujdesur për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues dhe në planifikimin vjetor qoftë për programet trajnuese ashtu edhe për buxhetin dhe menaxhimin me mjetet financiare.

² Rregullorja nr. 01/2018 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademi të Drejtësisë.

Në periudhën raportuese ka arritur Marreveshje të bashkëpunimit me Organizatat Joqeveritare, Agjencinë për informim dhe Privatesi, me KGJK dhe KPK, me Iniciativa për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor: Krimi i Rëndë dhe i Organizuar (si WBROLI SOC), Shkollen e Maxhistraturës së Shqiperisë si dhe me Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me përfaqësues të shumicës së Ambasadave në Kosovë, Zyrës së BE-së në Kosovë, Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, si dhe projekteve të shumta që mbështesin Akademinë e Drejtësisë në ofrimin e trajnimeve. Në këtë kuadër janë zhvilluar takimet e rregullta me zyrën e OPDAT pranë Ambasadës së SHBA -së në Kosovë, me projektet e USAID-it sikurse Projekti për Drejtësi Komerciale dhe Projekti për Drejtësinë në Kosovë, me Ambasadën Britanike, respektivisht me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosove”, me përfaqësues të projektit të BE / EUKOJUST, me projektet e KE “ JUFREX “ projektin “ Parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave” me projektin “Programi Evropian për Arsimimin e Profesionistëve Ligjor për të drejtat e Njeriut (HELP)”, projektet e tjera të mbështetura nga OSBE, UNDP, IFC, GIZ, IRZ, me odat e profesioneve të lira në Kosovë dhe partnerë tjerë. Në këto takime janë diskutuar nevojat dhe sfidat e AD-së në përmbushjen e mandatit ligjor, mundësitë e mbështetjes së projekteve, aktivitetet e realizuara dhe aktivitetet në proces si dhe çështje tjera të përbashkëta.

3.3.2 Zyra e Programeve Trajnuese- Departamentet e AD-së

Akademia e Drejtësisë për të realizuar funksionet e saj sipas ligjit është organizuar në punën e Zyrës së Programeve trajnuese, në kuadër të së cilës funksionojnë Departamenti i PTV-së, Departamenti i PTF-së dhe Departamenti i PHP-së si dhe Departamenti për Administratë dhe Financa. Përgjegjësia e zyrës së programeve trajnuese janë:

- Hartimi, mbikëqyrja e zbatimit dhe vlerësimi i i nevojave trajnuese;
- Koordinimi i hartimit të politikave, strategjive, objektivave dhe planeve për trajnime;
- Koordinimi i punës së departamenteve në funksion të zbatimit të trajnimeve.

Secili departament i programit udhëhiqet nga një udhëheqës të cilët po ashtu bëjnë pjesë në kategorinë e nivelit drejtues. Në kuadër të secilit program ka edhe nënkategori tjera të aktiviteteve të cilat janë në përshtatshmëri me funksionet themelore të secilit nga këto programe.

Departamenti për Administratë dhe Financave udhëhiqet nga Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili po ashtu është nivel drejtues dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme si: financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikës, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

4. Të arriturat dhe sfidat në zbatimin e Planit të Punës dhe të Performancës si dhe Programit Trajnues 2022

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2022 është përmbushur konform objektivave të përcaktuara për këtë vit dhe ka përfshirë aktivitete në funksion të zbatimit të Programeve trajnuese dhe aktivitete tjera që janë në funksion të procesit të punës në AD.

Komponentet kryesore të Planit të Punës dhe të performancës ishin:

Aftësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar si dhe përgatitja profesionale përshtatshme me rolin dhe detyrat e funksionit përkatës (Programi i Trajnimit Fillestar)

Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor në shkathtësitë dhe kompetencat profesionale dhe interdisciplinare (Programi i Trajnimeve të vazhdueshme)

Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesioneve të lira;

Rritja e cilësisë së programeve trajnuese, kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe veprimtarisë botuese (Programi për Hulumtime dhe Publikime)

Avancimi i metodologjisë trajnuese si pas standardeve dhe metodave bashkëkohore;

Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare.

Transparenë dhe marrëdhënie me publikun;

Përmirësimi i infrastrukturës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve të departamentit për administratë dhe financa

Programi Trajnues Kornizë 2021-2022, përkatësisht programi trajnues për vitin 2022 ka ofruar trajnimet nga fushat kryesore duke përfshirë aspektin material dhe procedural të punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Pra, Programi trajnues ka ofruar këtë përmbajtje:

Drejtësinë penale;

Programet e specializuara;

Drejtësinë civile;

Drejtësia për fëmijë, aspekti civil dhe penal;

Drejtësinë ekonomike;

Drejtësinë administrative;

Fusha e kundërvajtjeve;

E drejta kushtetuese;

Trajnimet për DHPGJS;

Trajnimet për KEDNJ dhe të Drejtën e BE-së;

Kompetenca interdisciplinare;

Trajnimet kundërdiskriminimit;

Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e IX;

Programi i Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e IX;

Programi për Hulumtime dhe Publikime;

Trajnimi i stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorëve;

Trajnimet për zyrtarët e Agjencisë për ndihmë juridike Falas;

Trajnimet për mbrojtësit e viktimave
 Trajnimin për përmbaruesit privat;
 Trajnimet e Trajnuesve;
 Trajnimet nga distanca;
 Trajnimet me donatorë.

4.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2022

Gjatë vitit 2022, Akademia e Drejtësisë është përballë me vështirësi veçanërisht në koordinimin e programeve dhe trajnuesve meqë krahas kërkesës së madhe për trajnime të vazhdueshme pothuajse paralelisht ka filluar me programin e trajnimit fillestar për 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX. Shtuar kësaj edhe zhvendosja e Akademisë së Drejtësisë në lokacionin e ri meqë objekti me qira në të cilin Akademia ka ushtruar veprimtarinë e saj është kërkuar të lirohet. Në anën tjetër objekti i saj që është në ndërtim e sipër nuk është përfunduar sipas kontratës për shkak të pengesave që kanë dalë gjatë procesit të ndërtimit.

Me gjithë këto vështirësi është arritë përzgjedhja e objektit dhe funksionalizimi i tij pa cenuar rrjedhën e programeve dhe aktiviteteve të saj.

Përveq sfidave të lartëpërmendura AD është përballë edhe me sfidat si në vijim:

- Numri i vogël i stafit dhe pengesat në plotësimin e vendeve të buxhetuara për shkak të mos kompletimit të legjislacionit primar dhe sekondar;
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të trajnimit veçanërisht të metodologjisë së trajnimit të bazuar në raste praktike, respektivisht në lidhje me praktiken e GJEDNj.
- Mungesa e stafit profesional të nevojshëm dhe të domsdoshëm;
- Mungesa e hapsirave të mjaftueshme dhe me paisjet e domosdoshme;
- Vështirësitë dhe pengesat në ndërtimin e objektit të AD-së;
- Zhvendosja nga objekti paraprak në objektin e ri me qira;
- Kërkesat e shumta për trajnime dhe mungesa e buxhetit.

Pavarësisht sfidave të lartëpërmendura, Akademia e Drejtësisë është angazhuar për ti adresuar dhe tejkaluar ato duke përmbushur me sukses aktivitetet e përcaktuara me planin e punës dhe jo vetëm por edhe aktivitete tjera të cilat kanë hyrë në program si rezultat i kërkesave nga partnerët ndërkombëtarë.

Për vitin 2023, aktivitetet e Akademisë që do të realizohen janë të përcaktuara në Programin Trajnues 2023 si dhe në Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2023. Këto aktivitete synojnë trajtimin e praktikës gjyqësore në të gjitha lëmitë me fokus në çështjet më sfiduese në procesin e bërjes së drejtësisë të cilat kanë qëllim tejkalimin e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të përfituesve të saj siq janë të përcaktuar me ligj.

4.2 Të arriturat në zbatimin e programit trajnues 2022

Pavarësisht sfidave dhe vështirësive të cilat janë theksuar në këtë raport, Akademia e Drejtësisë ka arritur që me sukses të përmbush gjitha programet dhe aktivitetet e saj sipas programit trajnues 2022.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare nga muaji korrik filloj trajnimi fil lestar për 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e sapo emëruar të cilët për Akademinë e Drejtësisë përbëjnë gjeneratën e IX. Që nga kjo periudhë janë zhvilluar sesionet trajnuese konform programit trajnues për këtë vit. Programi për gjyqtarët është dizajnuar që të zbatohet fillimisht me sesionet e trajnimit teorik i cili sipas kalendarit ka zgjatur deri në javën e parë të muajit shkurt 2023. Meqenëse numri prej 48 personave në një sallë është vlerësuar se nuk ofron komoditet dhe njëkohësisht cilësi dhe efekt të trajnimit është realizuar i ndarë në dy grupe, njeri prej 18 gjyqtarëve dhe tjetri grup prej 30 gjyqtarëve. Si rezultat i rrethanave politike 2 gjyqtarë të sapo emëruar nga radhët e minoriteteve, përkatësisht të nacionalitetit serb nga muaji nëntor janë dorëhequr dhe si rrjedhojë edhe nga trajnimi fillestar dhe 1 gjyqtare në pushimin e lehonisë. Trajnimi për 6 prokurorët është realizuar konform programit për prokuror dhe paralelisht trajnimi teorik dhe trajnimi praktik.

Ndërkaq në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme kanë qenë të planifikuara 113 aktivitete trajnuese për gjyqtarë, prokurorë, stafin administrativ dhe profesionet e lira, përfshirë këtu edhe Trajnimet e trajnuesve si dhe mësimi në distancë. Si rezultat i ndryshimeve legjislative veçanërisht për Kodin e Procedurës Penale si dhe kërkesave tjera nga projektet me donatorë janë shtuar edhe 22 trajnime, ndërsa sipas kërkesave tjera të pa planifikuara nga projektet me donatorë kanë realizuar 193 aktivitete trajnuese. Përveç aktiviteteve të planifikuara në formë të tryezave për unifikim të praktikës në të gjitha fushat, programet e specializuara për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, trajnimet për të drejtat e njeriut, drejtësinë për fëmijë, dhunën në familje si dhe trajnimet nga aspekti interdisiplinar janë realizuar edhe trajnimet në fushën e ndërmjetësimit, krimit kibernetik të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve nga departamentet përkatëse. Gjithashtu Strategjia për sundimin e Ligjit ka ndikuar në rritjen e një numri të konsiderueshëm të aktiviteteve të AD-së.

Përveç zbatimit të trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë janë zbatuar edhe një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve trajnuese sipas kurrikulës trajnuese për bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Gjatë këtij viti janë realizuar aktivitetet trajnuese nga moduli-aspekti penal material dhe procedural për të vazhduar më pas në vitin në vijim edhe me aspektin civil material dhe procedural. Janë realizuar edhe aktivitetet trajnuese sipas planifikimit për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe për profesionistët tjerë ligjor përkatësisht për përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave, ndërmjetësuesit, si dhe për zyrtarët e ndihmës juridike falas.

Programi për Trajnim Fillestar 2022									
Përfituesit				Sesionet e trajnimit				Trajnuesit	Mentorët
		Nr. i përgjith.	Të trajnuar	teorik	praktik	Ditë trajnimi	Nr. i orëve		
Gjenerata e VIII e gjyqtarëve		24	24	/	51	/	/	/	22
Gjenerata IX e gjyqtarëve	Gr. 1	48	45	204	612	102	612	37	/
		30	27						
	Gr. 2	18	18	204	612	102	612	37	/
Gjenerata IX e prokurorëve		6	6	84	71	113	252	19	5
Totali		78	75	492	1346	317	1476	93	27
Programi për Trajnim të Vazhdueshëm 2022									
Trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë (ku janë përfshirë edhe profesionistë tjerë ligjor)									
Përfituesit	Nr./aktiv		Të trajnuar	Pjesëmarrja në trajnime		Numri i trajnimeve		Nr. i trajnimeve në ditë	
Gjyqtar	388 ³		362 ⁴	2005		193		282	
Prokuror	183 ⁵		149	626					
Bashkëpuntorë profesional/zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive	Trajnime të përbashkëtat në PTV		144	206					
	Trajnime për Modulin bazik Penale-materiale dhe procedurale		164	701					
Stafi administ. gjyqësor dhe prokurorial	/		125	172					
TIT ⁶	7		/	62					
Profesionet e lira	10		64	135					
Mësimi në distancë									
Platformat		Progresi/Kurset e zhvilluara						Pjesëmarrës	
HELP		Qasja në drejtësi e grave Azili dhe të drejtat e njeriut Menaxhimi i rasteve						59	

Tabela Nr.1 Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2022

³ <https://www.gjyqesori-rks.org/raportet/> -Raporti statistikor i gjykatave nëntëmujori-2022⁴ Nga 362 gjyqtarë, 10 prej tyre ishin gjyqtarë nga Shqipëria si rezultat i një trajnimit të përbashkët me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë.⁵ <https://prokuroria-rks.org/psh/dokumente-publikime/108/165/665/665/>⁶ Të trajnuarit në TIT janë nga radhet e gjyqtareve, prokuroreve, Ekspert të TI, Zyrtar nga NJIF, Zyrtar Policor, AKSP, Avokat, Ndermjetesues etj.

4.3 Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit

Për vite me radhë gjyqësori ka pasur zhvillime të reja qoftë në lëvizjen e gjyqtarëve nga një nivel në nivelin tjetër, rekrutime të gjyqtarëve të rinj, ndryshime legjislative etj. Të gjitha këto edhe kërkesat e dokumenteve strategjike të vendit duke përfshirë edhe gjetjet e raportit të BE-së për Kosovën të cilat kërkojnë përmirësimin e cilësisë së punës në Gjykata dhe Prokurori kanë pasur impakt edhe në planet dhe programet e trajnimit të Akademisë.

Zhvillimet e Akademisë në raport me vitet paraprake janë të prezantuara më poshtë në formë tabelare.

Përshkrimi i aktivitetit	2020	2021	2022
Trajnime fillestare	12 prokurorët e sapo emëruar gjen. VIII -125 ditë trajnimi 37 gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. VII - 73 dite trajnimi	24 gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. VIII - 197 aktivitete trajnuese	48 ⁷ gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. IX - 204 sesione trajnuese në 102 ditë 6 prokurorët e sapo emëruar- 84 sesione në 42 ditë trajnimi teorik dhe 82 ditë trajnimi praktik
Tranime të vazhdueshme	109	128	143
Trajnime për stafin adm. të gjykatave/ prokurorive	10 sesione me 11 ditë trajnimi	9 sesione trajnuese me 10 ditë trajnimi	23 trajnime për bashkëpunëtorë profesional 10 trajnime për stafin tjetër me 13 ditë trajnimi
Trajnime për profesionet e lira	1 trajnim për permbaruesit privat, 4 trajnime për zyrtarët në ANJF 9 trajnime të përbashkëta (Avokatë shtetëror me gjyqtarë dhe prokurorë)	2 trajnime për permbaruesit privat 1 trajnim për zyrtarët në ANJF	10 trajnime (5 për zyrtarët e ndihmës juridike falas, 3 për mbrojtësit e viktimave dhe 2 për permbaruesit privat)
Aktivitete tjera⁸	179	122	324
Nr. i pjesëmarrësve gjyqtarë/prokuror në trajnime të vazhdueshme	2558	2992 ⁹ gjyqtarë, 723 ¹⁰ prokuror,	2005 gjyqtarë 626 prokurorë
Nr. i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar	37 gjyqtarë të sapo emëruar 12 prokurorë të sapo emëruar	24 gjyqtarë	48 gjyqtarë 6 prokurorë
Nr. i pjesëmarrësve nga stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial	105 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor si dhe 132 kategori tjera të stafit administrativ	49 bashkëp.prof dhe zyrtarë ligjor, 3 referentë dhe 1 mbrojtës i viktimave në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Në trajnime veçanërisht për stafin administrativ 185 gjithësejt	2984 pjesëmarrës që janë përfshirë qoftë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë ashtu edhe në trajnimet dedikuar veq profileve përkatëse
Numri i stafit të AD-së	27	26	25
Buxheti	519,903.26	531,549.16	660,149.00

Tabela nr.2. krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit

⁷ Trajnimin e kanë filluar 48 gjyqtarë të sapo emëruar, ndërkaq nga nëntori 2022, 2 gjyqtarë nga minoriteti serb janë dorëhequr për shkak të rrethanave politike dhe 1 gjyqtarë ka qenë në pushim të lehonisë.

⁸ Aktivitetet tjera nënkuptojnë, tryeza pune, konferenca, takime pune me trajnues dhe Kryetarë të Gjykatave e Kryeprokurorë të Prokurorive, Trajnime për Trajnues, vizita të ndërsjella në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë, punëtori të ndryshme, takime koordinuese etj.

⁹ Gjyqtarë që kanë marrë pjesë në më shumë trajnime se njëherë.

¹⁰ Prokurorë që kanë marrë pjesë në më shumë se njëherë në trajnime.

4.4 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë

Edhe në periudhën raportuese AD është përkushtuar në ngritjen e cilësisë së trajnimeve dhe avancimin e metodologjisë trajnuese përmes dizajnit të aktiviteteve të saj qoftë përmes tryezave, punës në grupe si dhe trajnimeve përmes rasteve studimore. Për këto aktivitete trajnuese në koordinim me organet drejtuese mbrenda AD-së, bazuar në vlerësimet për trajnues ka angazhuar trajnues me përvojë dhe shkathtësi në mësim dhënie të cilët kryesisht ishin nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga instancat më të larta.

Si ilustrim vetëm nga gjyqësori në trajnimet e vazhdueshme janë angazhuar 38 gjyqtarë ndërkaq në trajnimet fillestare 26 trajnues. Bazuar në të dhënat e AD-së nga Gjykata Supreme ishin 11 trajnues, Gjykata e Apelit 16 trajnues, nga Gjykata Komerciale 3 trajnues ndërkaq nga Gjykata Themelore 8 trajnues.

Në trajnimet fillestare nga Gjykata Supreme ishin 8 trajnues, nga Gjykata e Apelit 14 trajnues, ndërkaq nga Gjykata Themelore 4 trajnues.

Mesatarja e performancës së trajnuesve në trajnimet e vazhdueshme ishte 4.6 ndërkaq në trajnime fillestare ishte 4.3.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve trajnuese dhe avancimit të metodologjisë trajnuese AD ka realizuar trajnime të trajnuesve për disa fusha specifike. Në detaje është në vijim të këtij raporti te trajnimet e trajnuesve.

Për cilësi në trajnime gjithashtu AD në mbështetje të projekteve të ndryshme ka angazhuar ekspertizë ndërkombëtare veçanërisht për luftimin e krimit kibernetik, hetimeve financiare dhe në sfera tjera për të cilat sistemi ynë gjyqësor dhe prokurorial nuk e ka përvojën e duhur. Me rastin e hartimit dhe zbatimit të trajnimeve ka bashkëpunuar ngushtë me KGJK dhe KPK duke përfshirë edhe gjyqtarë, prokurorë si dhe trajnues me përvojë me qëllim të zbatimit të praktikave më të mira të trajnimit gjyqësor.

4.5 Procesi i vlerësimit të nevojave për trajnime dhe përditësimi i programeve trajnuese

Vlerësimi i nevojave trajnuese për gjyqtarë, prokurorë dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial është mandat i cili buron nga Ligji për AD-në. Ky vlerësim bëhet përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia dhe në bazë të kërkesave të KGJK-së dhe KPK-së.

Si çdo vit me radhë edhe gjatë vitit 2022 procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese ka filluar që nga zbatimi i Programit të Trajnimeve për vitin 2022, fillimisht me analizën dhe nxjerrjen e propozimeve nga formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues. Në gjysmëvjetorin e dytë të

këtij viti janë dërguar pyetësorët në gjykata dhe prokurori rezultatet e të cilave janë pranuar dhe janë marrë për bazë gjithashtu.

Në kuadër të këtij procesi janë përfshirë edhe takimet intenzive me kryetar të gjykatave, gjyqtarë dhe udhëheqës të departamenteve si dhe kryeprokuror të prokurorive të cilat janë realizuar kryesisht në muajt korrik, gusht, shtator dhe tetor të vitit 2022. Në vazhdim gjatë këtij viti janë përcjellë raportimet nga mediat për gjyqësorin, janë analizuar raportet dhe rekomandimet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit¹¹, raportet e punës të gjykatave dhe prokurorive si dhe agjenda legislative në Kuvendin e Kosovës. Rezultatet dhe gjeturat nga mekanizmat përkatës kanë qenë burime referuese dhe përcaktuese për programin trajnues për vitin 2022 nga krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe nga Këshilli Programor dhe Këshilli Drejtues i AD-së. Në vijim gjenden mekanizmat për vlerësim (burimet e informacionit) të cilat janë shqyrtuar dhe konsultuar nga Akademia e Drejtësisë gjatë procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese:

Formularët për vlerësim pas sesioneve trajnuese 2022	Rishikimi funksional për sundimin e ligjit
Pyetësori për vlerësimin e nevojave trajnuese	Strategjia shtetërore në luftën kundër korrupsionit 2019-2023
Propozimet e trajnueseve të përhershëm të AD-së	Strategjia në luftën kundër krimit të organizuar 2018-2023
Takimet e kryetar të gjykatave, gjyqtarë udhëheqës të departamenteve	Strategjia kombëtare për parandalimin dhe luftimin e e konomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023
Takimet me kryeprokuror dhe prokuror	Avokati i popullit
Raportet e punës së KGJK-së dhe KPK-së	Mediat e shkruara dhe elektronike
Raportet e punës së gjykatave dhe prokurorive	Agjenda legislative e Kuvendit të Kosovës
Strategjitë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave	Programet e institucioneve të trajnimit gjyqësor në nivel regional dhe ndërkombëtar
Strategjia për sundimin e Ligjit 2021-2026	Rekomandimet e shoqërisë civile
Strategjia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut 2021-2025	Agjenda legislative e kuvendit

Vlerësimi i nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është proces i cili ka rëndësi të veçantë dhe si i tillë ka kërkuar angazhim dhe përkushtim gjatë gjithë vitit. Gjetjet nga ky proces kanë kontribuar për Këshillin Programor si organ profesional për përcaktimin e prioritetëve dhe hartimin e Programit trajnues për vitin 2023.

¹¹ Akademia e Drejtësisë ka marrë përgjegjësi në përmbushjen e masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Strategjinë për sundimin e Ligjit dhe strategjitë tjera në të cilat ka marrë pjesë aktivisht edhe në hartimin e tyre..

Në periudhën raportuese AD prioritet ka pasur indikatorët sipas dokumenteve strategjike. Në vijim janë tabelat me masat që AD është dashur të përmbush gjatë vitit 2022.

Nr.	Strategjia	Indikatori	Aktivitetet e AD
1.	PKZMSA dhe ERA	Trajnime nga Fusha Komerciale	9 trajnime për Gjyqtarët e Gjykatës Komerciale gjatë vitit 2022
		Trajnime nga Fusha e sekuestrimit dhe konfiskimit;	Akademia e Drejtësisë, gjatë periudhës raportuese, ka zhvilluar 4 trajnime nga fusha e Hetimeve financiare, konfiskimit dhe sekuestrimit.
		Trajnime për Hetimet Financiare dhe rikuperimin e aseteve	Akademia e Drejtësisë, gjatë periudhës raportuese, ka zhvilluar 2 trajnime nga fusha e Hetimeve financiare, dhe 2 trajnime rreth rikuperimit të aseteve në bashkëpunim me Institutin e Baselit.
		Trajnime për pastrimin e parave	Akademia e Drejtësisë, gjatë periudhës raportuese, ka zhvilluar 2 trajnime nga fusha e Pastrimit të parave.

2.	Programi kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut	Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve kur në procedurë penale përfshihen kryerësit me çrregullime mendore.	2 trajnime ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore, njëri trajnim 2 ditor, kurse tjetri 1 ditor.
		Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e rasteve të dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual me një qasje të përqendruar nga viktimat;	AD gjatë vitit 2022 në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ka realizuar: 3 trajnime ,1 tryeze, 2 trajnime të trajnuesve (njëra për gjyqtare dhe prokurorë dhe tjetra me bashkëpunëtor profesional).
		Raportimi lidhur me numrin e trajnimeve të realizuara për ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht me theks të veçantë për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ)	4 trajnime rreth KEDNJ dhe 2 të tjera rreth Konventës së Stambollit

Nr.	Strategjia	Indikatori	Aktivitetet e AD
3.	Strategjia për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje	Ofrimi i trajnimeve për gjyqtarët/gjyqtarët dhe prokurorët/prokurorët për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe krimet në bazë gjinore-aspekti penal.	AD gjatë vitit 2022 në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ka realizuar:
		Ofrimi i trajnimeve për gjyqtarët për aspektin civil, përkatësisht procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, si dhe lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit, alimentacionin, mbajtjen financiare të bashkëshortit/es, etj.	3 trajnime 1 tryeze 2 trajnime të trajnuesve (njëra për gjyqtare dhe prokurorë dhe tjetra me bashkëpunëtor profesional).
		Trajnime të përbashkëta për trajtimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, për punonjëset dhe punonjësit e policisë, prokurorët/prokurorët dhe gjyqtarët/gjyqtarët në detyrë, Avokatët e Viktimave, QPS, MSH, MV, Psikiatria Forenzike, në aspektin penal dhe civil dhe ndikimit të traumës në viktimën	
		Zhvillimi i kurrikulave vjetore trajnuese për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve / gjyqtarëve, prokurorëve / prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional, mbrojtësve të viktimave dhe akterëve tjerë relevantë për zbatimin e drejtë dhe efektiv të legjislacionit me fokus në dënimet e kryerësve të veprave penale të dhunës në familje si dhe personat që shkelin urdhrat mbrojtës.	Kurrikula trajnuese për vitin 2022 është hartuar dhe miratuar nga Këshilli drejtues i AD-së. Kalendari i trajnimeve për gjashtëmujorin e parë është në proces të përmbushjes së aktiviteteve të planifikuara.

Nr.	Strategjia	Indikatori	Aktivitetet e AD
4.	Nën-komiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri, qershor 2021	Sigurimi i përdorimit të plotë të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Lëndëve (SMIL) për të gjitha rastet deri në dhjetor 2021 përmes trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit mbështetës dhe masave të tjera. (KGJK, KPK, AD)	Më 24 mars 2022, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i financuar dhe mbështetur nga Këshilli i Evropës, projekti - Forcimi i cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë në Kosovë KoSEJ II, u zhvillua trajnimi me temë: "Regjistrat, raportet statistikore dhe tabelat e SMIL", për stafin administrativ të gjykatave. Përfitues të trajnimit ishin gjithsej 35 pjesëmarrës nga radhët e Ndhmës Administratorëve, Shefave të ZKF-ve, nëpunësve, zyrtarëve statistikorë dhe zyrtarëve të TI-së brenda gjykatave. Në shtator 2022 është planifikuar trajnimi për Instrumentet kryesore të CEPEJ-it, duke filluar me raportet statistikore dhe tabelat për kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët në lidhje me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Lëndëve. Trajnimi është në fazën e përgatitjeve paraprake.

Nr.	Strategjia	Pyetjet për te cilat përgjigjet AD në pyetësor
5.	CEPEJ- E drejta e BE , Drejtësia për fëmijë , liria e shprehjes , etika , KEDNJ, lufta kundër krimit dhe korrupsionit, dhuna në familje , përdorimi i TI etj.	Trajnime fillestar Trajnim i përgjithshëm gjatë shërbimit Trajnim brenda shërbimit për funksione të specializuara gjyqësore (p.sh. gjyqtari për çështje ekonomike ose administrative) Trajnim brenda shërbimit për funksionet e menaxhimit të gjykatës (p.sh. kryetari i gjykatës) Trajnim gjatë shërbimit për përdorimin e pajisjeve kompjuterike në gjykata Trajnim gjatë shërbimit për etikën

Nr.	Strategjia	Indikatorët vetëm për vitin 2022
6.	Strategjia e Rishikimit Funkcional	Ofrimi i trajnimeve për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të performancës Përforsimi i mekanizmit të analizimit të vlerësimeve të performancës me qëllim të identifikimit të nevojave specifike për trajnim të gjyqtarëve Trajnime i ndërmjetësuesve, edukimi i stafit të gjykatave dhe nëpunësve të ndërmjetësimit për referim të rasteve Përcaktimi i kriterëve të rrepta dhe të qarta për zgjedhjen e mentorëve dhe trajnerëve. Sesione të rregullta të Trajnimit të Trajnerëve (TIT). Rishikimi i programeve të AD-së për rastet e dhunës në familje me qëllim të avansimit të tyre Ofrimi i trajnimeve të specializuara për gjyqtarë dhe prokurorë në fushat e identifikuar si mangësi gjatë vlerësimit të performancës. Hartimi i një kurrikule të re trajnuese të veçantë për Kryetarë të Gjykatave dhe Kryeprokurorë, me fokus në avansimin e aftësive të tyre menaxheriale dhe të tjera të nevojshme për pozitën e tyre udhëheqëse Ofrimi i trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për të gjithë anëtarët e rinj dhe të vjetër të KZR-së. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për konfiskimin e pasurisë Hartimi i Koncept Dokumentit mbi nevojën për një Ligj të veçantë për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për të përcaktuar arsimimin e vazhdueshëm ligjor të detyrueshëm për prokurorë dhe gjyqtarë Zgjerim i Platformës Elektronike të AD, për të përmbytur më shumë module të trajnimeve online Zhvillimi i një programi të trajnimit për përkthyes/interpretë të gjykatave për konceptet ligjore dhe Kodin e Etikës së Përkthyesve/Interpretëve me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve të përkthimit/interpretimit. Përkthimi në mënyrë sistematike i praktikës të përzgjedhur gjyqësore të GJEDNJ-së

Tabela nr. 3 indikatorët sipas strategjive për AD-në

4.6 Punëtori për hartimin e Programit trajnues për vitin 2023

Në periudhën raportuese AD ka realizuar dy (2) punëtori për hartimin e programit trajnues, një për trajnimin fillestar dhe një për trajnimin e vazhdueshëm. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte përcaktimi i Kurrikulës Trajnuese për vitin 2023, në pajtim me nevojat trajnuese të prokurorëve të sapo emëruar, gjenerata e IX, gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë si dhe profesionistëve tjerë ligjor krahas kërkesave dhe prioriteteve tjera të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Këshilli Programor ka qenë pjesë aktive në hartimin e programeve trajnuese. Për trajnimet e vazhdueshme Këshilli Programor ka bashkëpunuar ngushtë me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive si dhe ka pasur në konsideratë gjetjet nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese.

5. AKTIVITETET TRAJNUESE DHE AKTIVITETET E TJERA TË REALIZUARA SIPAS PROGRAMEVE TË AD -SË

Raporti në vijim përmban aktivitetet sipas programeve dhe objektivave si në vijim:

5.1 AFTËSIMI I GJYQTARËVE/PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR DHE PËRGATITJA PROFESIONALE PËRSHTATSHMËRISHT ME ROLIN DHE DETYRAT E FUNKSIONIT PËRKATËS (PROGRAMI I TRAJNIMIT FILLESTAR)

Trajnimi fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar është obligim ligjor sipas Ligjit për AD-në por edhe legjislacioni që rregullon gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës. Bazuar në legjislacionin në fuqi AD është përgjegjëse për organizimin e trajnimit fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar. Programi i trajnimit fillestar (më tutje PTF) zgjatë 12 muaj dhe realizohet sipas modelit të kombinuar të teorisë dhe praktikës.

Në kuadër të trajnimit teorik, programi përmban të gjitha degët e së drejtës dhe legjislacionin vendor në fuqi, Acquis Communautaire, Konventën Evropiane për të Drejta e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare të aplikueshme. Trajnimi teorik është i ndarë në sesione dhe realizohet përmes gjashtë (6) moduleve trajnuese bazë nga gjithsejtë 49 nën-module për gjyqtar të sapo emëruar dhe pesë (5) module nga gjithsejtë 35 nën module për prokuror të sapo emëruar. Modulet trajnuese janë të karakterit profesional dhe interdisiplinar dhe përfshijnë shqyrtim të rasteve nga praktika gjyqësore, zhvillim të shkathtësive në përfaqësim si dhe simulime në lëmin penale dhe civile.

Trajnimi praktik realizohet në gjykata dhe prokurori ku ata janë emëruar nën mbikëqyrje e mentorit dhe përfshinë aspektet praktike të punës së gjyqtarit/prokurorit. AD e monitoron këtë proces përmes koordinimit dhe punës së përbashkët me mentorë.

Pjesë përbërëse e programi trajnues janë edhe vizitat/trajnimet në institucione jo gjyqësore të cilat kanë për qëllim të ofrojnë njohuri gjyqtarëve/prokurove të shtetit të sapo emëruar me legjislacionin dhe praktikat që zbatojnë institucionet shtetërore gjatë punës së tyre, si dhe aktivitete që kryejnë këto institucionet, të ndërlidhura me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Për çdo modul trajnues në fund realizohet testi përfundimtar dhe raporti i vlerësimit për gjyqtarë dërgohet në KGJK, respektivisht Komisionin për Vlerësimin e Performancës si dhe për prokurorë në KPK, përkatësisht në Komisionin për Vlerësimin e Performancës brenda afatit të paraparë.

5.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Programin e Trajnimit Fillestar dhe Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2022

Në kuadër të trajnimit fillestar janë realizuar sesionet e fundit të trajnimit praktik për 24 gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VIII e me këtë edhe përfundimi i programit për këtë gjeneratë¹². Nga muaji korrik 2022 edhe aktivitetet trajnuese për gjeneratën e IX, përkatësisht për 48 gjyqtarë të sapo emëruar dhe 6 e prokurorëve të sapo emëruar për këtë vit.

Akademia e Drejtësisë me sukses ka përbushur programin trajnues për këto gjenerata komform objektivave që ishin në funksion të përgatitjes dhe aftësimi për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar duke përbushur kështu kompetencën profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Numri i madh i gjyqtarëve të rekrutuar nga KGJK gjatë vitit 2022, 48 gjithësejt (4 prej tyre nga mnoritetet) ka imponuar nevojën e ndarjes në dy grupe për zbatim të trajnimeve. Kjo për shkak të mungesës së hapësirës por njëkohësisht edhe vlerësimit se numri prej 48 personave në sallë nuk do të ofronte komoditet dhe njëkohësisht cilësi dhe efekt të trajnimit. Ndarja e gjyqtarëve në dy grupe ka qenë sfiduese si në koordinimin e trajnuesve në njërën anë ashtu edhe në rritjen e kostos financiare. Programi për gjyqtarë ka qenë i dizajnuar që të zbatohet fillimisht me sesionet e trajnimit teorik në pesë ditë të javës dhe ka rezultuar deri në fund të këtij viti, për të vazhduar më pas edhe sesionet e mbetura të trajnimit teorik dhe praktik në vitin 2023.

Krahas këtyre dy grupeve të gjyqtarëve, paralelisht është realizuar edhe trajnimi fillestar për 6 prokurorë të cilët në dy ditë të javës kanë ndjekur sesionet e trajnimit teorik, ndërkajq tre ditë tjera sesionet e trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse. Trajnimi fillestar është realizuar komform programit dhe kalendarit trajnues pa humbur as edhe një ditë trajnimi përkundër edhe zhvendosjes në objektin tjetër të Akademisë që ka ndodhur gjatë këtij viti.

PTF	Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve	Numri i të trajnuarve	Gjinia					Pjesëmarrja në trajnimin teorik	Pjesëmarrja në trajnime praktike	Nr. i trajnimeve në ditë	Nr. i trajnimeve teorik ne sesione	Nr. trajnimeve në orë	Nr. i trajnimit praktik	Nr. i trajnuesve të angazhuar	Nr. i mentorëve të angazhuar
			M	F	SH	SR	TJ								
Gjenerata e VIII e gjyqtarëve	24		16	8	22	2	0	/	24	51	/	/	51	/	22
Gjenerata e IX e gjyqtarëve	48 ¹	45	28	20	44	3	1								
	Gr. I	30	19	11	27	3	/	27	/	102	204	612	/	37	/
	Gr. I	18	9	9	17	/	1	18	/	102	204	612	/	37	/
Gjenerata e IX e prokurorëve	6	6	4	2	6	0	0	6	6	113	84	252	71	19	5
Totali	78	54	48	30	72	5	1	51	30	368	492	1,476	122	93	27

Tabela nr. 4 sesionet trajnuese për gjyqtarët/prokurorët e sapo emëruar, gjeneratën e VIII dhe IX në PTF

¹² Kjo gjeneratë ka filluar trajnimin me dt. 18 shkurt 2021, dhe ka përfunduar me 18 mars 2022

5.1.2 Zbatimi i trajnimit fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar gjatë vitit 2022

Zbatimi i trajnimit praktik për gjeneratën e tetë të gjyqtarëve të sapo emëruar (2021-2022)

Kjo gjeneratë e cila ka përfshirë 24 gjyqtarë të sapo emëruar, trajnimin fillestar e kanë vijuar me dt. 18 shkurt 2021 ndërkaq sesionet e fundit të trajnimit praktik në gjykatat përkatëse i kanë përfunduar me 18 mars 2022. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsejtë 51 ditë trajnimi praktik në lëmine penale në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit dhe vizita në institucione jo gjyqësore. Për realizimin e pjesës praktike janë angazhuar 22 mentor.

Në pajtim me Rregulloren për Trajnimin Fillestar, pas periudhës së trajnimit teorik dhe praktik në lëmin penalë është organizuar testi përfundimtar. Testi është hartuar nga trajnuesit e Akademisë, të cilët kanë qenë të përfshirë në realizimin e moduleve trajnuese si: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale dhe Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese. Pas përfundimit të testit është bërë vlerësimi përfundimtar dhe në vijim janë përgatitur raportet përfundimtare për secilin gjyqtarë dhe janë dërguar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, respektivisht Komisionin për Vlerësimin e Performancës brenda afatit të paraparë.

5.1.3 Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve për gjeneratën e VIII të 24 gjyqtarëve të sapo emëruar në fushën hulumtuese dhe qasjen në burime ligjore

Pjesë e programit të trajnimit fillestar edhe punimet hulumtuese të cilat janë obligative për të gjithë vijuesit e këtij programi. Gjyqtarët e kësaj gjenerate kanë përzgjedhur tema të cilat ishin me interes për praktikën gjyqësore dhe në funksion të kësaj kanë bërë hulumtime. Punimet hulumtuese të 24 gjyqtarëve të kësaj gjenerate janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga Komisioni për vlerësimin e punimeve i themeluar nga Këshilli Drejtues i AD-së të cilë ishin nga radhët e trajnuesve në PTF. Punimet hulumtuese i janë bashkangjitur dosjes dhe raportit përfundimtar për përfundim të trajnimit fillestar.

5.1.4 Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e radhës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.

Në hap me zhvillimet në gjyqësor, Akademia e Drejtësisë është angazhuar në hartimin e programit trajnues për gjeneratën e radhës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj meqenëse ishin në proces të rekrutimit nga KGJK dhe KPK. Programi është hartuar sipas afateve të përcaktuara duke iu përshtatur nevojave trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët e kësaj gjenerate dhe përshtatshmërisht me ndryshimet legjislative. Programi është shqyrtuar nga Këshilli Programor dhe më pas është rekomanduar për miratim në Këshillin Drejtues.

5.1.5 Zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e nëntë të gjyqtarëve të sapo emëruar (2022-2023)

Gjenerata e nëntë, (48) gjyqtarë të sapo emëruar, kanë filluar trajnimin fillestar me 15 korrik 2022. Programi trajnues është realizuar në mënyrë intensive e po ashtu i ndarë në dy grupe për shkak të numrit të madh të gjyqtarëve. Me kërkesën e KGJK-së është filluar me trajnimin teorik për 6 muaj pa ndërprerje në lëmin penale dhe civile. Gjatë vitit 2022, janë realizuar 5 muaj trajnim teorik, në total 204 aktivitete trajnuese, prej tyre 102 ditë trajnimi për secilin grup.

Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore dhe gjykime të simuluar, bazuar në module trajnuese ku përfshihen trajnime nga të gjitha degët e së drejtës dhe ligjet pozitive, Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe akteve të tjera ndërkombëtare.

Sipas programit trajnues fillestar për gjyqtarët janë realizuar gjashtë module trajnuese. Në këtë gjeneratë të ndarë në dy grupe në trajnim teorik në total janë realizuar 408 sesione trajnuese apo 1224 orë trajnim.

Gjatë vitit 2022, në trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (grupi i parë dhe i dytë) kanë realizuar modulet si në vijim:

- **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** - nga ky modul janë realizuar gjithsejtë 74 sesione apo 222 orë. Ky modul ka trajtuar pjesën e përgjithshme dhe pjesën e veçantë të Kodit Penal. Në kuadër të pjesës së përgjithshme janë trajtuar: elementet e veprës penale, vepra penale dhe përgjegjësia penale, mbrojtja e nevojshme, dhuna dhe kanosja, dashja, pakujdesia, lajthimi, bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, shtytja, marrëveshja për të kryer vepër penale, dënimet plotësuese, pasojat juridike, rehabilitimi i të dënuarave dhe parashkrimi. Ndërsa nga pjesa e veçantë janë trajtuar: Veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës dhe veprat penale kundër integritetit seksual, veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit publik, veprat penale të narkotikëve, veprat penale kundër ekonomisë, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI- të KPRK-së, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI- të KPRK-së, veprat penale nga kapitulli 401 i KPRK-së, korrupsioni, ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, kapitulli XXVIII, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë. Në këtë modul janë trajtuar edhe krimi kibernetikë, politika ndëshkimore dhe përgjegjësia e personave juridik.
- **Kodi i Procedurës Penale** – nga ky modul janë realizuar 88 sesione trajnuese apo 264 orë. Në kuadër të këtij moduli janë trajtuar: Procedura paraprake, roli i gjyqtarit në procedurën paraprake, masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, parimet, kompetencat dhe përjashtimi i gjyqtarit në procedurën penale, masat e sigurisë së të pandehurit në procedurën penale, prokurori i shtetit, mbrojtësi, i dëmtuari dhe i pandehuri në procedurën penale, dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale, shqyrtimi fillestar dhe i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore juridike, procedura sipas mjeteve juridike, aktgjykimi dhe llojet e tij, procedura penale e kryerësve me çrregullime mendore, procedurat e veçanta sipas KPPK-së, provat në procedurën penale dhe procedurat alternative.

- **Shkathtësitë personale dhe interdisiplinare** – nga ky modul janë realizuar gjithsejtë 31 sesione trajnuese apo 93 orë. Temat e trajtuara në këtë nën modul janë: Etika profesionale dhe përgjegjësia disiplinore, parimet e Kodit të Etikës, përgjegjësia, shkeljet dhe masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe procedura disiplinore për gjyqtarët, rregullat e komunikimit, menaxhimi i rasteve dhe matja e performancës, ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve dhe arsyetimi i vendimeve në lëmin penale.
- **Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar** - Në ky modul janë realizuar 38 sesione trajnuese apo 114 orë. Në kuadër të këtij moduli janë trajtuar: Drejtësia kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, bashkëpunimi juridik në lëmin penale dhe civile, dhe e drejta e Bashkimit Evropian. Gjithashtu hapësirë të gjerë trajtimi i është dhënë edhe Konventës Evropiane për të Drejta e Njeriut ku në hollësi janë trajtuar: Neni 2, Neni 5 par.1 - Presumimi në favor të lirisë, garancitë procedurale në rastet e heqjes së lirisë, Neni 6.1 dhe Neni 10 – Liria e shprehjes.
- **Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësues** – nga ky modul janë realizuar 26 sesione trajnuese apo 78 orë. Në kuadër të këtij moduli janë trajtuar: Kodi i drejtësisë për të mitur, ndërmjetësimi në çështje civile, kundërvajtje si dhe zhvillimi i shkathtësive gjyqësore.
- **E drejta civile, administrative dhe ekonomike** – nga ky modul janë realizuar 151 sesione trajnuese apo 453 orë. Në kuadër të këtij moduli janë trajtuar: e drejta civile, procedura kontestimore pjesa e parë, procedura kontestimore pjesa e dytë, procedura jo kontestimore, procedura përmbartimore, e drejta administrative, e drejta e detyrimeve, e drejta ekonomike, e pronësisë dhe të drejtat e tjera të përafërta, e drejta trashëgimore, e drejta e punës, dhe e drejta familjare.

Këtë program deri në fillim të nëntorit e kanë ndjekur 48 gjyqtar ku tre prej tyre janë të komunitetit serb dhe një boshnjak. Gjyqtarët nga radha e komunitetit serb nga dt. 08 nëntor 2022, nuk kanë vijuar trajnimin fillestar pasi të njëjtit kanë dhënë dorëheqje nga Gjykata Themelore Mitrovicë për shkak të zhvillimeve politike në vend.

Në realizimin e trajnimit teorike kanë qenë të angazhuar 37 trajnues, prej tyre 7 nga Gjykata Supreme, 16 nga Gjykata e Apelit, 3 nga Gjykata Themelore, 4 nga Zyra e Prokurorit të Shtetit, 4 të tjerë - ekspert nga fusha e BE-së, profesor universitar dhe dy trajnues të përhershëm të Akademisë. Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe metodologjisë trajnuese. Në programin e trajnimit fillestar janë përdorur këto metoda trajnuese: Raste praktike, simulim i gjykimeve dhe teknika të zhvillimit të përfaqësimit në gjykim.

5.1.6 Zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e nëntë të prokurorëve të sapo emëruar (2022-2023)

Gjenerata e nëntë (6) prokurorë të sapo emëruar, ka filluar trajnimin fillestar me 04 korrik 2022. Programi trajnues është realizuar paralelisht, trajnim teorik i realizuar në Akademinë e Drejtësisë (dy ditë në javë) dhe trajnim praktik (tri ditë në javë) i realizuar në prokuroritë përkatëse nën

mbikëqyrjen e mentorit. Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore dhe simulime gjykimi.

Në trajnimin fillestar për prokuror në total janë realizuar gjithsejtë 113 ditë trajnimi, prej tyre 42 ditë trajnimi teorik dhe 71 ditë trajnim praktik.

Në kuadër të trajnimit teorik sipas programit trajnues fillestar për prokurorët janë realizuar pesë (5) module trajnuese, 84 sesione trajnues dhe 252 orë.

- **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** - nga ky modul janë realizuar 25 sesione trajnuese apo 75 orë. Në kuadër të pjesës së përgjithshme janë trajtuar: elementet e veprës penale, vepra penale dhe përgjegjësia penale, mbrojtja e nevojshme, dhuna dhe kanosja, dashja, pakujdesia, lajthimi, bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale, shtytja, marrëveshja për të kryer vepër penale, dënimet plotësuese, pasojat juridike, rehabilitimi i të dënuarave dhe parashkrimi. Gjithashtu nga pjesa e veçantë janë trajtuar: Veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës, veprat penale kundër integritetit seksual, veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit publik, veprat penale të narkotikëve, veprat penale kundër ekonomisë, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI- të KPRK-së, veprat penale në kuadër të kapitullit XXVI- të KPRK-së, veprat penale nga kapitulli 401 i KPRK-së, korrupsioni, ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, kapitulli XXVIII, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë.
- **Kodi i Procedurës Penale** – nga ky modul janë realizuar 34 sesione trajnuese apo 102 orë. Në kuadër të këtij moduli janë trajtuar: kallëzimi penal, masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit, masat e sigurisë së të pandehurit në procedurën penale, fillimi i hetimeve, vendi i ngjarjes dhe fornezika, ekspertiza dhe analiza, kontrolli dhe konfiskimi dhe dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale.
- **Shkathtësitë personale dhe interdisiplinare** – nga ky modul janë realizuar 17 sesione trajnuese apo 51 orë. Temat të cilat janë trajtuar në kuadër të këtij moduli janë: Etika profesionale dhe përgjegjësia disiplinore, rregullat e komunikimit, ngritja e shkathtësive sociale e prokurorëve dhe menaxhimi i stresit, dhe menaxhimi i rasteve dhe matja e performancës.
- **Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar** – nga ky modul janë realizuar 6 sesione trajnuese apo 18 orë. Në kuadër të këtij nën moduli janë trajtuar këto tema: Konventa Evropiane për Lirit dhe të Drejtat e Njeriut dhe drejtësia kushtetuese në raport me sistemin prokurorial dhe gjyqësor.
- **Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese** - nga ky nën modul janë realizuar 2 sesione trajnuese apo 6 orë. Në këtë nën modul është realizuar ligji për kundërvajtje.

Në këtë gjeneratë gjatë vitit 2022 kanë qenë të angazhuar 5 mentor të cilët e mbikëqyrnin trajnimin praktik në prokurori. Për zbatimin e trajnimit teorik janë angazhuar 19 trajnues prej tyre: 1 gjyqtarë nga Gjykata Supreme, 4 nga Gjykata e Apelit, 4 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 4 nga Prokuroria Speciale, 3 nga Prokuroria Themelore, 1 trajnues i përhershëm nga Akademia e Drejtësisë dhe 2 profesor universitar. Këto dy gjenerata të gjyqtarëve dhe prokurorëve do të vazhdojnë trajnimin sipas programit trajnues deri në fund të korrikut të vitit 2023.

5.2 AVANCIMI I VAZHDUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTËVE TJERË LIGJOR NË SHKATHTËSITË DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE DHE INTERDISIPLINARE (PTV)

Trajnimet e vazhdueshme sipas Ligjit për AD-në i dedikohen gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë duke përfshirë edhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistët tjerë ligjor. Ky program trajnimi ka për qëllim rritjen edhe më tej të kapaciteteve etike, profesionale, dhe praktike për ushtrimin e funksioneve përkatëse. Nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme Akademia e Drejtësisë synon gjithashtu pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

5.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2022

Trajnimet e vazhdueshme ishin të fokusuara në:

- Zbatimi i trajnimeve të specializuara;
- Zbatimin e trajnimeve sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Zbatimin e trajnimeve interdisiplinare për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile;
- Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK;
- Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion si dhe
- Zbatimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

5.2.2 Aktivitetet trajnuese në PTV

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2022, në kuadër të PTV-së janë realizuar 193 aktivitete trajnuese me 282 ditë trajnimi. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këto aktivitete trajnuese ishte 3216 pjesëmarrës.

Për më në detaje shih të dhënat në tabelat si në vijim:

Trajnimet e vazhdueshme-2022															
Trajnime pergjyqtare, prokuror dhe profesioniste tjerë ligjor	Ditë trajnimi	PTV	Trajnime të përbashkëta gjyqtarë/pro kurorë		Trajnime vetëm për gjyqtarë		Trajnime vetëm për prokurorë		Për bashkëp. profesion.		Për Stafin admini.		Profesion e te lira		TIT
193	282	143	114	237 ditë	24	35 ditë	5	10 ditë	23	23 ditë	10	13 ditë	10	10 ditë	7 19 ditë

Gjyqtarët në trajnime-2022					
Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në sistem	Nr. i pjesëma rrësve	Nr. i të trajnuarve	Nr. i trajnimeve për gjyqtarë		Nr. i ditëve të trajnimit për gjyqtarë
388	2005	362	24	114	272
			138		

Prokurorët në trajnime-2022					
Numri i përgjithshëm i prokurorëve në sistem	Nr. i pjesëmarrësve	Nr. i të trajnuarve	Nr. i trajnimeve për prokuror		Nr i ditëve të trajnimit për prokuror
183	626	149	5	114	247
			119		

Bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor në trajnime-2022						
Nr. i përgjithshëm i trajnimeve	Nr. i pjesëmarrësve	Nr. i të trajnuarve	Gjykata/Prokuroria/KPK			Nr i ditëve të trajnimit
23	748	179	Pjesëm 318	Pjesëm 428	2	23
			Trajnuar 83	Trajnuar 95	1	

Stafi tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial në trajnime-2022						
Nr i përgjithshëm i trajnimeve	Nr. i pjesëmarrësve	Nr. i të trajnuarve	Gjykata/Prokuroria/KPK			Nr i ditëve të trajnimit
10	172	138	Pjesëm. 99	Pjesëm.71	Pjesëma.2	13
			Trajnuar 80	Trajnuar 56	Trajnuar 2	

Profesionet e lira në trajnime-2022						
Nr i përgjithshëm i trajnimeve	Nr. i pjesëmarrësve	Nr. i të trajnuarve	ANJF	Permbarues	Mbrojtës te viktimave	Nr i ditëve të trajnimit
10	135	64	Pjesëm. 85	Pjesëm. 26	Pjesëm. 24	10
			Trajnuar 28	Trajnuar 19	Trajnuar 17	

Tabela nr. 5 pjesëmarrja dhe numri i të trajnuarve në PTV

5.2.3 Zbatimi i trajnimeve cilësore të specializuara në drejtësinë penale

Trajnimet e specializuara janë pjesë integrale e programit trajnues dhe janë specifike meqë kanë trajtuar forma të veçanta të krimit të cilat ekskluzivisht janë kompetencë e departamentit special të Gjykatës dhe Prokurorisë Speciale ose edhe janë bërë si fenomen në shoqëri dhe luftimi i tyre është prioritet për drejtësinë kosovare. Gjithashtu janë programe që trajtojnë aspektet ligjore si dhe teknikat e zbatimit praktik nga procesi i identifikimit dhe hetimit deri te vendimet përfundimtare. Këto programe trajnuese përveq asaj që u theksua më lartë kanë adresuar edhe vështirësitë dhe problemet praktike të cilat janë identifikuar me rastin e vlerësimit të nevojave trajnuese, përfshirë këtu edhe i Strategjisë për sundimin e ligjit.

Në kuadër të Programeve të Specializuar janë trajtuar temat si:

- Krimi i organizuar dhe korrupsioni-3 sesione në kohëzgjatje 6 ditore;
- Pastrimi i parave dhe hetimi financiar- 3 sesione trajnuese, në kohëzgjatje 6 ditore;
- Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare- 3 sesion trajnues në kohëzgjatje 6 ditore;
- Prokurimi publik- 2 sesione trajnimi me kohëzgjatje 4 ditore;
- Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi - 2 sesione trajnimi me kohëzgjatje 4 ditore;
- Krimi Kibernetik dhe kriptovalutat - 2 sesione trajnuese me kohëzgjatje 6 ditore trajnimi,
- Dhuna në familje dy ditë trajnimi si dhe
- Hartimi i akteve akuzuese nga prokuroria Speciale-1 sesion, 1 ditor.

Qëllimi i trajnimeve të specializuar ishte:

- Adresimi i nevojave për zhvillim profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve që merren me luftimin e veprave të korrupsionit;
- Avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë në zbatimin drejtë të dispozitave ligjore lidhur me kualifikimin juridik të veprave të pastrimit të parave, kryerjen e hetimeve pro aktive penale dhe financiare;
- Zbatimi i drejtë të dispozitave ligjore të kapitullit të veprave penale të korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare;
- Avancimi i njohurive të përfituesve të të gjitha fazave të prokurimit publik si procedurat të prokurimit publik, dosjes se tenderit, fazave të prokurimit publik, si dhe identifikimin e indikatorëve të korrupsionit që lidhen me prokurimin publik;
- Avancimi i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në funksion të hetimit dhe gjykimin efektiv, të pavarur dhe profesional rreth ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit;

- Ngritja e njohurive të përfituesve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe mundësisë së ndjekjes së suksesshme të krimit kibernetikë, përcaktimit të provave elektronike, ëndësinë dhe veçoritë e tyre;
- Avancimi i njohurive lidhur me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me dhunën në familje, hetimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në familje, njohjen e formave të manifestimit të dhunës në familje, duke përfshirë dhunën fizike, psikike e ekonomike.
- Avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me përshkrimin e veprave penale dhe përmbledhjen e fakteve në përpilimin e diapozitivit të aktakuzës, unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me hartimin e akteve akuzuese, arsyetimin e drejtë të akteve akuzuese dhe aktet tjera nga PSRK-ja dhe DS.

Pjesëmarrja në trajnimet e specializuara

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2022, janë realizuar 9 trajnime të specializuara, me 17 sesione trajnimi, dhe me 35 dite trajnimi. Numri i pjesëmarrësve në këto trajnime ishte 390. Prej tyre 238 gjyqtarë, 99 prokuror, 14 Bashkëpunëtor Profesional, 17 Ekspert të PSRK, 10 Hetues/Zyrtarë nga Polica e Kosovës, 6 Zyrtarë të Shërbimit Sprovues, 4 Zyrtarë Ligjor, 1 Staf administrativ dhe 1 Ndërmjetësues.

Detajet në vijim për çdo trajnim të specializuar:

1. PST-Krimi i organizuar				
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	28	5	11	44
Prokurorë	7	5	4	16
Bashkëp. profesion.		3		3
Ekspert të PRSK		5		5
Staf administ.		1		1
Totali gjithësejt	35	19	15	69

2. PST-Prokurimi publik			
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Totali
Gjyqtarë	11	5	16
Prokurorë	6	2	8
Ekspert të PRSK	5		5
Hetues-Policia e Kosoves	5	3	8
Bashkëpunëtorë profesional		5	5
Totali	27	15	42

3. PST-Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare				
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	29	13	32	74
Prokurorë	4	6	4	14
Bashkëpunëtorë profesional		1		1
Totali gjithësejt	33	20	36	89

4. PST-Patrimi i parave dhe hetimi financiar				
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	8	6	4	18
Prokurorë	11	5	7	23
Totali gjithësejt	19	11	11	41

5. PST-Krimi kibernetik dhe kriptovalutat			
Pjesëmarrësit	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	9	8	17
Prokurorë	5	2	7
Ekspert të PRSK		5	5
Totali gjithësejt	14	15	29

6. PST-Dhuna në familje	
Pjesëmarrësit	Sesioni dy ditor
Gjyqtarë	50
Prokurorë	17
Totali gjithësejt	67

7. PST-Krimet e luftës	
Pjesëmarrësit	Sesioni një ditor
Gjyqtarë	12
Prokurorë	3
Bashkëp. profesional	6
Zyrtarë ligjor	1
Zyrtarë nga FDH	2
Totali gjithësejt	24

8. PST-Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi			
Pjesëmarrësit	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	4	3	7
Prokurorë	1	1	2
Ekspert të PRSK	2		2
Hetues-Policia e Kosoves	2		2
Bashkëpunëtorë profesional & zyrtarë ligjor	1	5 3	6
Zyrtarë nga Shërbimi Sprovues	3	3	6
Ndërmjetësues		1	1
Totali gjithësejt	13	16	29

9. PST-Hartimi i akteve akuzuese	
Pjesëmarrësit	Sesioni një ditor
Gjyqtarë	12
Prokurorë	12
Totali gjithësejt	24

Tabelat nr. 6: Trajnimet e specializuara dhe pjesëmarrja

5.2.4 Zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Programi Trajnues i Akademisë së Drejtësisë ka ofruar trajnime dhe aktivitete tjera trajnuese nga të gjitha fushat e së drejtës përfshirë atë: civile, penale, drejtësinë për fëmijë në aspektin penale dhe atë civil, ekonomike-komerciale, administrative, kundërvajtje, KEDNJ, BE dhe Ndërkombëtare.


Pjesëmarrja në këto trajnime është bërë sipas aplikimit. Në periudhën raportuese AD ka pranuar rreth 7500¹³ aplikime ndërkaq kanë marrë pjesë vetëm 3216 pjesëmarrës.

Raporti në vijim përfshinë aktivitetet e realizuara sipas fushave, trajnimet e realizuara në baza mujore, numrit të pjesëmarrjes dhe kohëzgjatjes së trajnimeve.

¹³ Gjyqtarët dhe prokurorët aplikojnë për të marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme dhe mbi bazën e aplikimit bëhen përgatitjet tjera për trajnim.

Trajnimet sipas fushës-2022	Gjithsej trajnime	Gjithsej pjesmarrës
Administrative	7	78
Civile	16	492
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	2	34
Drejtësia për Fëmijë - Civile	2	33
Drejtësia për Fëmijë - Penale	6	115
E drejtë e BE-së	1	25
E drejtë e punës	1	18
Ekonomike	13	167
Interdisiplinare	3	41
KEDNJ	14	346
Kundërvajtje	3	50
Kushtetuese	1	9
Ndërmjetësimi	3	64
Penale	71	1744
Totali	143	3216

Tabela nr.7 trajnimet sipas fushave dhe pjesëmarrja



Grafikoni nr. 2: Numri i trajnimeve të realizuara në PTV sipas fushave në vitin 2022



Grafikoni nr. 3 Numri i trajnimeve të realizuara në baza mujore



Grafikoni nr. 4 Trajnimet sipas kohëzgjatjes në PTV

5.2.5 Trajnimet e vazhdueshme në fushën penale (materiale dhe procedurale)

Drejtësia penale vazhdon të përballët me sfida në luftimin e formave të reja dhe të sofistikuar të kriminalitetit që kërkojnë përmirësim të legjislacionit, dhe njëherësh rritjen e kapaciteteve profesionale. Në funksion të kësaj, Programi i trajnimit të vazhdueshëm në fushën penale i ka dhënë prioritet Programeve të specializuara të trajnimit, ndryshimeve legjislative, përkatësisht trajnimeve për risitë e Kodit të Procedurës penale si dhe trajnime tjera që kanë përfshirë praktikën gjyqësore në këtë fushë si për aspektin material ashtu edhe atij procedural. Këto aktivitete janë adresuar në formë të trajnimeve, punëtorive dhe të tryezave.

Trajnimet tjera nga lëmia penale

Në vitin 2022, janë realizuar 71 aktivitete trajnuese nga lëmia penale. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë trajtuar çështje nga e drejta penale materiale dhe procedurale si në vijim:

Nga e drejta materiale penale janë realizuar trajnimet si: Veprat penale kundër mjedisit, Uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave, Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik, Veprat penale kundër jetës dhe trupit me fokus te vepra penale e vrasjes dhe vrasjeve të rënda, Veprat penale kundër narkotikëve me theks të veçantë kur kryhen në formë të organizuar, Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale, mundësitë dhe sfidat, Përgjegjësia penale e personave juridik.

Këto tema janë trajtuar me qëllim që pjesëmarrësit të:

- Avancojnë njohuritë për veprat penale kundër mjedisit;
- Zbatojnë në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me uzurpimin e paligjshëm të pronave të paluajtshme;
- Zbatojnë drejtë legjislacionin lidhur me krimet e urrejtjes;
- Avancojnë njohuritë për veprat penale të vrasjes dhe format e kualifikuara dhe të privileguara të saj;

- Identifikojnë elementet e veprave penale lidhur me narkotikë të rrezikshëm dhe substanca psikotrope;
- Avancojnë njohuritë rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar për çështjet penale.

Nga e drejta procedurale penale janë realizuar trajnimet si: Trafikimi me qenie njerëzore, Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore dy trajnime, Provat në procedurën penale, Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit si dhe Mbrojtja e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve (viktimize), dëshmitarët bashkëpunues ky trajnim është realizuar i ndarë në 3 sesione nga dy ditë, gjithsej 6 ditë trajnimi, Paraburgimi dhe masat tjera për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, Shqyrtimi gjyqësor dhe gjykimi në mungesë, Mjetet juridike në procedurën penale, Kompensimi i viktimave të krimit në kuadër të sistemit juridik të Republikës së Kosovës,

Trajnimet nga fusha procedurale kishin qëllim që pjesëmarrësit të:

- Identifikojnë saktë elementet të veprave penale të trafikimi me njerëz;
- Avancojnë njohuritë lidhur me veçoritë e procedurës penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore;
- Zbatimot në drejtë bazën ligjore për sigurimin dhe përdorimin e provave;
- Vlerësojnë drejtë elementet për përcaktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë;
- Zbatojnë drejtë procedurën e shqyrtimit fillestar dhe në shqyrtimin e dytë;
- Zbatimin e drejtë të rregullave të përgjithshme lidhur me mjetet juridike.

5.2.6 Trajnime nga fusha Komerciale

Në periudhën raportuese është zbatuar kurrikula trajnuese e cila ka përfshirë 9 module trajnuese e në funksion të rritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale. Këto module kanë trajtuar çështjet si në vijim:

Vështrim i thelluar mbi procedurën e falimentimit;
 Të drejtat e pronësisë intelektuale, markat tregtare, patentat;
 Zbatimi dhe specifikat e direktivave të BE-së dhe rregulloreve ndërkombëtare në lidhje me çështjet komerciale, fiskale dhe doganore
 Specifikat e së drejtës fiskale tatimore dhe buxhetore;
 Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare;
 Procedura e Përmbarrimit, baza ligjore, dhe mjetet juridike;
 Implikimet praktike të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
 Kontrata e ndërtimit;
 Përmbledhje e specifikave të industrisë së TIK -ut licencimit dhe të drejtave të pronësisë.

Përveq moduleve të lartëpërmendura janë realizuar edhe edhe katër (4) trajnime në fushën ekonomike, ku janë trajtuar çështjet si: Njohja dhe përmbarrimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit vendor dhe të huaj, zbatimi i të Drejtave Pronësore intelektuale, zbatimi i të Drejtave Pronësore Intelektuale si dhe trajnim mbi të Drejtën e Insolvences së Shoqërive Tregtare.

Si rezultat i këtyre trajnimeve pjesëmarrësit kanë qenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë për rolin e gjyqtarëve në procesin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit;
- Avancojnë njohuritë mbi bazat ligjore dhe standardet ndërkombëtare dhe të BE-së për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;
- Rrisin njohuritë e tyre mbi bazat ligjore dhe standardet ndërkombëtare dhe të BE-së për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në mjedisin digjital;
- Njohin procedurat e insolvencës.

5.2.7 Trajnimet nga E Drejta Kushtetuese

Në periudhën raportuese është realizuar një (1) trajnim nga lëmia e së drejtës kushtetuese me temë: Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave ankesave në lëmin penale. Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e aftësisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth procedurës se lejueshmërisë së kërkesave, raportit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese, njohjes me praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëmin penale, si dhe kuptojnë rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

5.2.8 Trajnime për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme

Në Programin Trajnues të vitit 2022 nuk kanë munguar edhe trajnimet dedikuar ekskluzivisht Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Për këtë kategori përfituese janë realizuar dy (2) trajnime si: Kontrolli gjyqësor ndaj vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit dhe Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit – likuidimi të ndërmarrjeve shoqërore nga AKP.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte rritja e kapaciteteve profesionale për:

Procedurën për paraqitjen e kërkesave/ankesave në Dhomën e Posaçme;
Zbatimin e afateve kohore për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë;
Zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore të cilat aplikohen varësisht nga vendimi i kundërshtuar;
Zbatimin e saktë të procedurës së privatizimit dhe likuidimit;
Vlerësimin e drejtë kur transformimi i një NSH-je ka qenë apo nuk ka qenë diskriminues;
Kompetencat e Agjencisë lidhur me administrimin e NSH-ve dhe
Identifikimin e personave që kane të drejt të marrin pjesë në procesin e privatizimi dhe likuidimit.

5.2.9 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve

Kurikula trajnuese në fushën e kundërvajtjes ishte e fokusuar kryesisht në zbatimin e akteve normative të cilat rregullojnë vepra të ndryshme kundërvajtëse, duke veçuar Procedurën kundërvajtësve sipas kërkesës se inspektoreve, Prishja e Rendit dhe Qetësinë Publike si dhe Personat Juridik si kryes të kundërvajtjes.

Përmes këtyre trajnimeve është synuar ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në:

Zbatimin drejtë të procedurës së kundërvajtjes, nxjerrjes së aktgjykimit ligjor duke i aplikuar drejtë dispozitat ligjore;
Identifikimin e veprimet inkriminuese kundërvajtëse nga lëmi i mbrojtjes së rendit dhe qetësisë publike.

5.2.10 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe BE-së

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2022 ka realizuar tetë (8) trajnime dhe pesë (5) tryeza regjionale. Këto aktivitete kishin qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe efektet e saj në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar temat si: Ndalimi i torturës - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, E drejta në pronë-Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokolit nr1. I KEDNJ, E drejta për jetë private, jetë familjare, të vendbanimit dhe korrespondencës, për tu martuar dhe krijuar familje dhe për barazi të bashkëshortëve – neni 8 KEDNJ-së, E drejta për një proces të rregullt gjyqësor, Trajnim tematik në fushën e shpifjes dhe mbrojtjes së reputacionit, Mbrojtja dhe siguria e gazetarëve, Zbatimi i nenit 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Aspekti material dhe procedural i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij dhe KEDNJ-së në rastet e diskriminimit përfshirë edhe Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi i Republikës së Kosovës dhe raporti i tij me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore.

Të gjitha tryezat kanë trajtuar aspekte të rëndësishme të Lirisë së Shprehjes dhe Mediave

Objektivë e këtyre aktiviteve ishte rritja e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësi do të jenë në gjendje që të:

Kushtet dhe kujdesin shëndetësor në paraburgim dhe përgjegjësitë gjyqësore;
Të drejtën e pronës sipas KEDNJ dhe jurisprudencës së GJEDNJ;
Natyren juridike të jetës familjare;
Kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt;
Konceptin e shpifjes;
Detyrimet pozitive të shtetit dhe rastet konkrete;
Elementet thelbësore të secilës formë të diskriminimit;
Interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Në periudhën raportuese janë realizuar 2 trajnime për të drejtën e BE-së. Trajnimi i parë ishte me me theks te Praktika gjyqësore në çështjet civile, administrative dhe komerciale sipas Gjykatës Evropiane të Drejtësisë”. Qëllim i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve të Gjykatës Komoerciale për vlerat juridike të Bashkimit Evropian duke ofruar shpjegime profesionale dhe analize të marrëdhënieve në mes sistemeve juridike të shteteve anëtare dhe të drejtës evropiane me theks te Standardet e përgjithshme evropiane në çështjet ekonomike - buxhetore dhe obligimet e shteteve anëtare dhe atyre që janë candidate, Njohja me vendimet e

Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian dhe autorizimet e saja, dhe Njohja me Traktatin e Lisbonës dhe me parimet e Kopenhagës të cilat kanë të bëjnë me shtetet candidate.

Trajnimit i dytë ka trajtuar aspekte të rëndësishme të Zbatimit dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, direktivave dhe rregulloreve të UE-së, mbi çështjet komerciale, fiskale dhe doganore, në veçanti ndryshimet Legjislative me Ligjin e ri të së Drejtës Ndërkombëtare Private.

Përmes këtyre trajnime është synuar të:

Analizohet drejtë efekti i së drejtës evropiane në nivel nacional (efekti i drejtpërdrejt dhe i tërthortë);

Zbatojnë drejtë të legjislacionit e BE-së në nivel nacional;

Zbërthejnë raste praktike të zbatimit të së drejtës së BE-së nga ana e gjykatave të një shteti anëtarë të BE-së.

5.2.11 Trajnimet nga fusha e ndërmjetësimit

Në periudhën raportuese janë realizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve trajnuese në këtë fushë. Për detaje gjenden të dhënat në vijim të këtij raporti ku trajtohen Trajnimet për trajnues. Poashtu janë realizuar 3 sesione trajnuese për ndërmjetësimin që ishin regjionale dhe kanë përfutur gjyqtarë, prokurorë dhe ndërmejtësues nga regjioni i Gjilanit, Ferizajit dhe Pejës.

5.2.12 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes trajnimeve dhe tryezave në fushën penale

Realizimi i trajnimeve përmes metodologjisë së tryezave ishte rezultat i kërkesave dhe nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të unifikuar praktikën gjyqësore në çështje civile, penale, administrative në drejtësinë për fëmijë për të gjitha nivelet e instancave gjyqësore. Tëzërat kanë shërbyer si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale.

Gjatë vitit 2022, janë realizuar 3 aktivitete trajnuese në formë të tryezave me temat: Politika ndëshkimore dhe zbatimi i udhëzuesit, Sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe Veprat penale kundër integritetit seksual. Qëllimi i këtyre tryezave ishte njoftimi i pjesëmarrësve me Risitë e Kodit të Procedurës penale lidhur me efektin e matjes së dënimit, zbatimin e rrethanave relevante me rastin e caktimit të dënimit si dhe zbatimin e udhëzuesit për politikën ndëshkimore, identifikimin e problemeve ligjore lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin si dhe zgjerimin e njohurive të pjesëmarrësve lidhur me procedurën penale kur kryesi është i rritur.

Trajnimet për Risitë e Kodit të Procedurës Penale

Në kuadër të programit të vazhdueshëm janë realizuar 8 trajnime, me kohëzgjatje 2 ditore për Risitë e Kodit të Procedurës Penale. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me Risitë e Kodit të Procedurës Penale. Në kuadër të këtyre trajnimeve janë trajtuar: Mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimë, Hedhja e kallëzimit penal/e drejta për të apeluar aktvendimin, Masat e veçanta hetimore, Masat e veçanta hetimore, Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë, Hetimi (afati i

hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve), Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, Qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor, Sekuestrimi dhe konfiskimi, Gjykimi në mungesë, Seanca për caktimin e dënimit, Standardi i rishikimit të ankesave (shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit dhe rigjykimi), Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore, Procedurat për pezullimin e personit zyrtar nga detyra. Këto trajnime janë realizuar si trajnime regjionale. Gjithsejtë janë realizuar 16 ditë trajnime.

5.2.13 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes trajnimeve dhe tryezave në fushën civile

Në periudhën raportuese në fushën civile janë realizuar gjithsejtë 16 aktivitete trajnuese me 492 pjesëmarrës. Aktivitetet në fushën civile janë realizuar kryesisht në formë të tryezave, me ç ‘rast janë diskutuar çështjet familjare, çështje nga procedura kontestimore, përmbarimore dhe jokontestuese, çështjet pronësore, unifikimi i praktikës gjyqësore, mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës, fusha e ndërmjetësimit si dhe çështje tjera të cilat vazhdojnë të jenë sfiduese për gjyqtarë.

Tryezat shërbyen si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtarët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduara. Çështjet u trajtuan duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e gjykatës së shkallë së dytë dhe të tretë e të cilat u prezantuan përmes rasteve konkrete me qëllim të avancimit të aftësive të përfaqësuesve të gjyqësorit që të angazhohen për funksionimin e mirë, gjykimin efektiv, të pavarur dhe profesional.

Prezantimi i temave ishte përmes paraqitjes rasteve praktike të ndërlidhura drejtpërdrejtë me çështjet që u trajtuan. Për parashtrimin e rastit moderatori në tryeza ka marrë në konsideratë aspektet faktike dhe juridike të rastit, duke parashtruar pyetje/dilema mbi të cilat u zhvilluan diskutimet. Moderatori ka qenë i përgatitur dhe i hapur për të diskutuar rastet e ndërlidhura me temën e sesionit përkatës duke nxitur diskutimin interaktiv dhe analitik të çështjes përkatëse, por duke ofruar njëkohësisht pikëpamjet teorike/doktrinare, perspektiven ligjore dhe atë të praktikës gjyqësore si mbështetje për përfundimet e mundshëm që dolën nga rastet që u diskutuan.

Adresimi i secilës çështje të përmbledhur të këtyre tryezave është bërë edhe përmes një prezantimi teorik të nocioneve dhe kuptimeve tjera të secilës çështje të ngritur dhe njëkohësisht janë pasuar me shembuj për secilën temë/çështje. Në fund të punimeve në tryezë moderatorët kanë hartuar një raport përmbledhës për tryezën e mbajtur. Me qëllim që raporti të shërbej për të shpërndarë rezultatet e tryezës por edhe për të identifikuar ndonjë çështje që duhet të përfshihet në programet e Akademisë për trajnime apo eventualisht edhe të trajtohen nga seanca e përgjithshme Gjykatës Supreme të Kosovës me qëllim të Identifikimit të sfidave për zbatimin e dispozitave të Ligjore, Identifikimin e praktikave jo unike në gjykatat e instancave më të ulëta, si dhe adresimi i sfidave përmes prezantimit të praktikës unike gjyqësore si konkluzion.

5.2.14 Tryezat dhe trajnimet nga Drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal

Në fushën e drejtësisë për fëmijë janë realizuar 6 trajnime, prej tyre katër (4) nga aspekti penal dhe dy (2) tryeza nga aspekti civil.

Në aspektin civil janë trajtuar tema si: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre dhe Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje.

Qëllim i këtyre tryezave ishte ngritja e aftësive dhe shkathtësive të gjyqtarëve lidhur me:

- Mbrojtjen gjyqësore të fëmijëve në rastet pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre dhe në rastet e dhunës në familje

Në aspektin penal janë trajtuar tema si: Ndryshimet në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturit, veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve, marrja e deklaratës së fëmijëve - viktimë nga eksperti.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive dhe shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me:

- Identifikimin dhe interpretimin e saktë të dispozitave të reja ligjore;
- Vlerësimin e drejtë rreth kushteve për shqiptimin e masave si dhe të dënimeve;
- Intervistimin e drejtë forenzik të fëmijëve.

5.2.15 Trajnimet dhe tryezat nga fusha Administrative

Trajnimet në fushën administrative kanë adresuar sfidat në interpretimin e drejtë dhe të saktë të legjislacionit, me theks në interpretim dhe zbatimin të konfliktit administrativ dhe ndërlidhja në mes procedurave të parapara në ligjet e veçanta me Ligjin për Procedurën Administrative dhe Ligjin mbi Konfliktin Administrativ.

Në fushën administrative janë realizuar gjashtë (6) aktivitete trajnuese, prej tyre pesë (5) trajnime dhe një (1) tryezë. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar aspekte të rëndësishme si : Konflikti Administrativ, objekti dhe procedura konfliktit administrativ, Roli dhe zbatimi i Ligjit për Azilin si dhe raporti i tij me Konventën ndërkombëtare për azilin, zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe mbrojtja administrative dhe gjyqësore e të drejtave personale si dhe Ligji për qasje publike dhe procedurën e realizimit të drejtave për qasje në informative, aplikimi i Kodit Doganor dhe i akcizave të Kosovës, skemat pensionale, të financuar sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe Tryeza e rumbullakët nga gjyqësia administrative:” Praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme, Departamenti për çështje administrative të Gjykatës së Apelit dhe Departamentit për çështje administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte rritja edhe më tej e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në:

- Interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore për procedurën administrative dhe procedurën e konfliktit administrativ;
- Avancimin e njohurive për rolin dhe identifikimin e karakteristikave të Ligjit për Azilin të Kosovës;
- Zbatimin e drejtë të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës;
- Interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore në fuqi për pensionet bazike të moshës;

Evidentimin e dilemave që janë paraqitur në praktikën gjyqësore të departamentit administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

5.2.16 Zbatimi i trajnimeve interdisiplinare për gjyqtarë dhe prokurorë

Në kuadër të kompetencës interdisiplinare janë realizuar shtatë (7) trajnime. Një (1) trajnim për Menaxhimin e Stresit, një (1) për Zhvillimin e shkathtësive të përfaqësimit në gjykim, një (1) për për Instrumentet kryesore të CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitet të Drejtësisë)- Sistemi Evropian i Informacionit për Evidencën Penale që ka të bëjë me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Rasteve, tri (3) për Arsytimin e vendimeve gjyqësore, prej tyre 2 për aspektin penal dhe një për aspektin civil dhe një (1) për qasjen dhe përdorimin e rregullt të sistemit të evidencës penale. Moduli: Sistemi Evropian i Informacionit për Evidencën Penale.

5.2.17 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK

Risitë e Kodit të Procedurës Penale

Me qëllim të përgatitjes së gjyqtarëve, prokurorëve, avokateve, në zbatim të Kodit të ri të Procedurës Penale, AD në mbështetje të zyrës së OPDAT, të Ambasadës së SHBA -së në Kosovë ka amandementuar programin trajnues dhe ka realizuar 24 trajnime për ndryshimet në legjislacionin bazik në fushën penale, prej tyre 8 trajnime dy ditore për Risitë e Kodit të Procedurës Penale me qëllim të informimit të gjyqtarëve, prokurorëve, mbrojtësve të viktimave, avokatëve dhe bashkëpunëtorëve profesionale lidhur me Risitë e Kodit të Procedurës penale.

Gjatë këtyre trajnimeve janë trajtuar: Mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, Hedhja e kallëzimit penal e drejta për të apeluar aktvendimin, Masat e veçanta hetimore, Njohja e dëshmitarëve, Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë, Hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve), Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, Qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor, Sekuestrimi dhe konfiskimi, Gjykimi në mungesë, Seanca për caktimin e dënimit, Standardi i rishikimit të ankesave (shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit dhe rigjykimi), Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, Shkresat / thirrjet elektronike/seanca virtuale, Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore si dhe Procedurat për pezullimin e personit zyrtar nga detyra.

5.2.18 Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion

Për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të cilët avancohen nga një nivel në tjetrin, apo nga një departament në tjetrin, AD bazuar në mandatin ligjor ofron trajnime adekuate me qëllim të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të tyre të karakterit profesional, interdisiplinar dhe personal. Këto programe orientuese zhvillohen dhe zbatohen sipas kërkesave të KGJK-së dhe KPK-së. Në periudhën raportuese nuk ka pasur trajnime për avancim meqë këto trajnime vijnë si rezultat i kërkesave nga KGJK dhe KPK.

5.2.19 Bashkëpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e Trajnimeve të Vazhdueshme

Në periudhën raportuese nuk ka munguar mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë. Veçanërisht ka qenë e theksuar në ofrimin e ekspertizës për trajnime specifike dhe në ngritjen e kapaciteteve të trajnuesve duke mos lenë asesi anash zhvillimin e metodologjisë bashkëkohore trajnuese.

Në tabelen në vijim pasqyrohet nr. i trajnimeve të realizuara si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me partnerë dhe donatorë të ndryshëm të cilët e mbështesin sistemin e drejtësisë.

Nr. i trajnimeve të realizuara nga Akademia e Drejtësisë në Bashkëpunim me Donatorët 2022 PTV	Nr.i Trajnimeve
Akademia e Drejtësisë	69
Mbështetje te Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit për Ndihmë Shtetërore	1
Ambasada Amerikane	18
Bashkimi Evropian - EUKOJUST	5
Bashkimi Evropian Kosovë - Mbështetja e BE-së për Sistemin e të Drejtave Pronësore Intelektuale në Kosovë	2
EULEX	3
GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)	6
Humanitarian Law Center Kosovo	1
ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës	1
INJECT	1
IPROCEEDS	1
IRZ (German Foundation for International Legal Cooperation)	3
Këshilli i Evropës - JUFREX (Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe)	6
OSBE	4
Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës - KRCT	1
Qendra Kosovare për Studime Gjinore	3
Shkolla e Magjistratues në Shqipëri	1
UNDP	2
UNHCR	1
USAID / Drejtësia Komerciale	13
US-DOJ/OPDAT	1
Totali	74
Gjithsej trajnime	143

Tabela nr. 8: Numri i trajnimeve në bazë të financuesit

5.2.20 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional

Roli i bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor është i veçantë dhe ndikon në zhvillimin, avancimin dhe ngritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor. Andaj, ngritja e kapaciteteve profesionale ka qenë një ndër prioritetet e Akademisë së Drejtësisë. Në këtë kuadër janë realizuar 23 trajnime nga moduli i trajnimit bazik-aspekti penal, material dhe procedural.

Në pjesën penale materiale janë realizuar 3 module trajnimi për 4 grupe të pjesëmarrësve me gjithsej 12 trajnime. Modulet janë si ne vijim:

Moduli bazik aspekti penal material - Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përgjashtimit të Kundërligjshmërisë, Pjesa e Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat Penale kundër integritetit Seksual - tre (3) trajnime:

Moduli bazik aspekti penal material - Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se. tre (3) trajnime:

Moduli bazik aspekti penal material / Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit tre (3) trajnime:

Në pjesën penale procedurale janë realizuar 3 module trajnimi për 4 grupe të pjesëmarrësve me gjithsej 11 trajnime. Modulet janë si ne vijim:

Fazat e procedurës penale tre (3) trajnime:

Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi (2 trajnime)

Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta tre (3) trajnime:

Këto trajnime i kanë vijuar përveq bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive edhe zyrtarë tjerë. Në vijim tabelat me detajet:

Bashkëpunëtorë profesional / Zyrtar ligjor	
Trajnime të realizuara	23
Ditë trajnimi	23
Pjesëmarrës në trajnime	748
Meshkuj	285
Femra	463
Shqiptarë	720
Serb	25
Boshnjak	3

Pjesëmarrja në trajnime	Totali i pjesëmarrjes në trajnime	Të trajnuar
Bashkëpunëtorë profesional	452	105
Zyrtar i lartë ligjor & Zyrtar ligjor	249	59
Referent i lartë & Referent	11	3
Administrator	6	1
Mbrojtës të viktimave	2	1
Staf tjetër administrativ nga Gjykata dhe Prokuroria	28	10
Totali	748	179

Trajnimet sipas financuesit	Trajnime
Akademia e Drejtësisë	17
UNDP	6
Totali	23

Tabela nr. 9: Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe në bazë të financuesit

5.2.21 Trajnimet për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Në përmirësimin e efikasitetit të punës së gjykatave dhe prokurorive rol të veçantë kanë edhe stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Andaj, në këtë kuadër janë realizuar gjithësejt dhjetë (10) trajnime përmes të cilave është synuar ngritja e vazhdueshme profesionale dhe rritja e efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori. Programi trajnues për këto kategori ka ofruar module trajnuese që ka adresuar aspekte të rëndësishme të punës së stafit duke filluar nga menaxhimi i punës dhe dosjeve, komunikimi, përdorimi i SMIL dhe aspekte tjera të punës sipas funksioneve përkatëse. Këto trajnime i kanë vijuar bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë të lartë ligjor, referentë, administratorë, zyrtarë për informim dhe profile tjera.

Në vijim tabelat me detajet:

Trajnimet për Stafin administrativ nga Gjykata dhe Prokuroria	
Trajnime të realizuara	10
Ditë trajnimi	13
Pjesëmarrës në trajnime	172
Meshkuj	77
Femra	95
Shqiptarë	165
Serb	6
Boshnjak	1

Përfituesit nga trajnimet për stafin administrativ	Pjesëmarrja në trajnime	Të trajnuar
Bashkëpunëtorë profesional	14	3
Zyrtar i lartë ligjor & Zyrtar ligjor	48	41
Referent i lartë & Referent	18	17
Administrator & Ndihmës Administrator	22	18
Mbrojtës të viktimave	1	1
Staf tjetër administrativ nga Gjykata dhe Prokuroria	69	48
Totali	172	128

Trajnimet sipas financuesit	Trajnime
Akademia e Drejtësisë	6
Ambasada Amerikane	1
Këshilli i Evropës - CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitet të Drejtësisë)	1
Këshilli i Evropës - JUFREX (Reinforcing Judicial Expertise on Freedom of Expression and the Media in South-East Europe)	2
Totali	10

Tabela nr. 10: Trajnimet për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive dhe në bazë të financuesit

5.2.22 Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesioneve të lira –

Zbatimi i trajnimeve për profesionet e lira

Në periudhën raportuese, profesionistët nga radhët e profesioneve të lira kanë marrë pjesë edhe në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë por edhe në trajnime të veçanta dedikuar kategorive përkatëse.

Për Mbrojtësit e viktimave janë realizuar gjithësejt tri (3) trajnime në kuadër të cilave kanë përfutur 22 zyrtarë nga Zyra për mbrojtje të viktimave dhe 2 praktikantë nga kjo zyre.

Për përmbauesit privat janë realizuar dy (2) trajnime të cilat i kanë vijuar 26 përmbaues privat. Për zyrtarët e ndihmës juridike falas janë realizuar pesë (5) trajnime të cilët i kanë vijuar 85 pjesëmarrës.

Këto trajnime janë realizuar me kërkesën e institucioneve përkatëse dhe në mbështetjen e GIZ.

Në tabelën në vijim pasqyrohen detaje sa i përket pjesëmarrjes në trajnime nga profesionet e lira:

Trajnimet për Mbrojtësit e Viktimave	
Trajnime të realizuara	3
Ditë trajnimi	3
Gjithsej pjesëmarrës	24
Meshkuj	14
Femra	10
Shqiptarë	23
Boshnjak	1

Pjesëmarrja në trajnimet për ZMNV	Pjesëmarrja në trajnime	Të trajnuar
Zyrtar për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave	22	16
Praktikant në ZMNV	2	1
Totali	24	17

Trajnimet për Përmbaruesit Privat	
Trajnime të realizuara	2
Ditë trajnimi	2
Gjithsej pjesëmarrës	26
Meshkuj	20
Femra	6
Shqiptarë	26

Pjesëmarrja në trajnimet për Përmbaruesit privat	Pjesëmarrja në trajnime	Të trajnuar
Përmbarues Privat	26	19

Trajnimet për zyrtarët e Ndhmës Juridike Falas	
Trajnime të realizuara	5
Ditë trajnimi	5
Gjithsej pjesëmarrës	89
Meshkuj	44
Femra	45
Shqiptarë	84
Serb	5

Pjesëmarrja në trajnimet për ANJF	Pjesëmarrja në trajnime	Të trajnuar
Zyrtar nga ANJF	85	28
Gjyqtarë	3	2
Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional	1	1
Totali	89	31

Tabela nr. 11 Profesionet e lira në trajnimet e AD-së

5.2.23 AVANCIMI I METODOLOGJISË TRAJNUESE SIPAS STANDARDEVE DHE METODAVE BASHKËKOHORE -TRAJNIMET PËR TRAJNUES

Zhvillimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë

Akademia e Drejtësisë në periudhën raportuese është angazhuar të zhvilloj programin trajnues të përhershëm për trajnues dhe mentorë i cili synonë ngritjen e aftësive dhe strategjive të mësimdhënies si dhe avancimin e teknikave për aplikimin e metodologjisë moderne trajnuese. Ky program është në proces të dizajnit dhe pritet të bëhet në bashkëpunim me OPDAT i cili do të mbështet me ekspertizë ndërkombëtare.

Zbatimi i trajnimit për trajnues

Për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të trajnimit, të gjitha trajnimet e trajnuesve gjatë vitit 2022 janë zhvilluar në bashkëpunim me donatorët e AD-së të cilët përveç mbështetjes teknike, kanë pasuruar trajnimet edhe me ekspert dhe trajnues ndërkombëtar, të cilët me përvojën dhe njohuritë e tyre ishin një aset i çmuar për trajnuesit vendorë të AD-së

Bazuar në Programin Kornizë 2021-2022, Akademia e Drejtësisë për vitin 2022 ka realizuar Trajnime të Trajnuesve, shumica prej tyre me sesione të vazhdueshme trajnimi si në vijim:

Trajnim i Trajnuesve (4 ditor) në fushën e Krimit Kibernetik. Ky trajnim ishte rezultat i bashkëpunimit me projektin e Këshillit të Evropës, projekti iPROCEEDS. Nga procesi i rekrutimit kanë rezultuar 15 kandidatë nga sistemi gjyqësor, prokurorial si dhe nga njësia e hetimeve nga Policia e Kosovës;

Trajnim i Trajnuesve (2 ditor) në fushën e Financimit të Terrorizmit. Ky trajnim ishte rezultat i bashkëpunimit me projektin e Këshillit të Evropës, projekti PECK III. Trajnimi ishte vazhdimësi e Trajnimit të Trajnuesve që është realizuar gjatë vitit 2021. Me këtë rast janë certifikuar 15 pjesëmarrës (Gjyqtarë, Prokurorë, Hetues Policor, zyrtarë nga NJIF).

Trajnim i Trajnuesve (3 ditor) në fushën e Luftës dhe fuqizimit të Institucioneve vendore ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. Faza e I-rë ka filluar me pjesëmarrës bashkëpunëtor profesional të gjykatave dhe prokurorive, mbrojtës të viktimave, zyrtarë nga Agjencia për barazi gjinore si dhe hetues policor. Faza e II-të është zhvilluar në dhjetor 2022, dhe ka përfshirë 11 gjyqtarë dhe prokurorë, kryesisht koordinatorët e luftimit të dhunës në familje të caktuar nëpër gjykata dhe prokurori;


Trajnim i Trajnuesve me 3 sesione të ndryshme trajnimi (3 ditore dhe 4 ditore secila) në fushën e Ndërmjetësimit. Ky proces ka filluar që në Mars të vitit 2022, me rekrutimin e 15 ndërmjetësuesve të cilët janë pjesë e Programit për ToT, që AD është duke e zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së.

Gjatë sesionit të I-rë të gjithë pjesëmarrësit janë njoftuar me trajnimet bazike rreth ndërmjetësimit, kryesisht në mënyrën e përgatitjes së trajnimit, gjuhën e trupit, përmbajtjen e power point etj.

Sesioni i II-të ishte më i fokusuar në çështjet e ndërmjetësimit nga fusha familjare, pronësore dhe komerciale.

Gjatë sesionit të III-të, ndërmjetësuesit kanë punuar në grupe me nga (5) persona, e ku kanë demonstruar njohuritë e tyre në zhvillimin e trajnimeve në grup. Ky proces pritet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023, me 2 sesione tjera të specializuara të trajnimit, e që do i paraprijë certifikimit të pjesëmarrësve.

Vlen të theksohet se AD, të gjitha Trajnimet e Trajnuesve i ka zhvilluar përmes shpalljeve publike, me qëllim të transparencës, dhe ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor, që kanë interes të jenë pjesë e programeve trajnuese të AD-së.



Grafikoni nr. 5 Trajnimet për Trajnues sipas temave dhe pjesëmarrjes

5.2.24. Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

Mësimi në distancë është një komponentë shumë e rëndësishme për Akademinë e Drejtësisë. Është zbatuar që nga viti 2021 dhe atë përmes platformës ILIAS duke mundësuar kurset online në periudha të caktuara kohore që kanë shërbyer si alternativë për marrjen e informacionit për çështjet ligjore që kanë ofruar kurset përkatëse për gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive etj.

Gjatë vitit 2022 është investuar në ndryshimin e platformës së mësimin në distancë dhe nga platforma ILIAS është kaluar në platformën MOODLE e cila është vlerësuar si më funksionale për përdorim. Kjo platformë pritet të funksionalizohet në vitin 2023 përmes tranimit të stafit për përdorim dhe në vijim kalimin e kurseve të zhvilluara nga ILIAS në MOODLE dhe me zhvillimin e kurseve të reja trajnuese të cilat do të integrohen në platformë dhe do të jenë të çashtme në të dy gjuhët (Shqip dhe Serbisht).

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës janë zhvilluar kurse trajnimi për “*Dhunën ndaj grave dhe dhunës në familje*”, “*Azili dhe të drejtat e njeriut*”. Inkurajimi i përfituesve të AD-së në kurset e kësaj platforme është bërë përmes shpalljeve publike.

Gjatë vitit 2023 pritet të funksionalizohet edhe një kurs tjetër në platformën HELP, “*Qasja në drejtësi e grave*”. Kursi është zhvilluar dhe përkthyer i tëri, vetëm pritet të bëhen edhe përgatitjet me mentorët e kursit për hapjen zyrtare.

Përveç Këshillit të Evropës, AD ka bashkëpunuar edhe me Institutin CEELI, me qëllim të zhvillimit të mësimin në distancë. Kështu, nga bashkëpunimi me këtë Institut është zhvilluar edhe një kurs special në gjuhën angleze për Gjyqtarët dhe Prokurorët, me temë: “*Judicial Case Managment*”

6. RRITJA E CILËSISË SË PROGRAMEVE TRAJNUESE, KAPACITETEVE ANALITIKE DHE HULUMTUESE SI DHE VEPRIMTARISË BOTUESE -PROGRAMI PËR HULUMTIME DHE PUBLIKIME

Programi për Hulumtime dhe Publikime është pjesë e Departamentit të Programit i cili ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial përmes ofrimit të burimeve të nevojshme juridike si dhe zhvillimin e programeve trajnuese të AD-së përmes analizave dhe veprimtarisë kërkimore.

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë përmes këtij programi kryen analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë vitit 2022 në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete në drejtim të:

- Zbatimit të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues si dhe Planit të punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2023
- Veprimtarisë botuese për nevoja të zbatimit të programit të trajnimit fillestar me theks te zhvillimi i moduleve trajnuese;
- Ofrit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;
- Hartimit të raporteve në zbatim të masave dhe politikave euro integruese;
- Hartimit dhe publikimit të buletinit informativ në baza mujore;
- Koordinimit me kompaninë kontraktuese për furnizimin me materialet e nevojshme për shtyp dhe shërbime të dizajnit për AD-në si dhe
- Përditësimit të statistikave dhe data bazës me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së.

6.1. Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues për vitin 2023

Në kuadër të këtij programi është realizuar procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë dhe stafin mbështetës, i cili ka parapri hartimit të programit trajnues dhe përcaktimit të kurrikulës trajnuese. Ky proces ka kërkuar angazhim dhe përkushtim gjatë gjithë vitit meqenëse i bëhet analizë dhe krahasim të gjithë mekanizmave për vlerësim me qëllim që programi trajnues të jetë i përshtatshëm me nevojat dhe funksionet përkatëse. Në këtë vështrim janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë mbledhë dhe përpunuar të dhënat nga analiza e formularëve të vlerësimit pas sesioneve trajnues gjatë vitit 2022;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga pyetësorët për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Realizimi i takimeve me trajnues të AD-së, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë mbikëqyrës si dhe përfaqësues nga KGJK dhe KPK;
- Shqyrtimi i propozimeve dhe rekomandimeve nga Strategjia për sundimin e Ligjit, dhe dokumentet tjera strategjike të cilat kanë relevancë për gjyqësorin duke përfshirë edhe raportin e BE-së për Kosovën dhe kërkesat e MSA-së.
- Shqyrtimi i portaleve të gjykatave dhe prokurorive duke marrë për bazë edhe raportet e punës së tyre si dhe

- Në vazhdimësi është përcjellë agenda legislative në kuvend si dhe mediat dhe portalet të cilat kishin në fokus gjyqësorin e Kosovës.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga burimet e lartë përmendura është finalizuar me *Raportin analizë nga vlerësimi i nevojave trajnuese për vitin 2023* i cili i ka shërbyer Këshillit Programor të AD-së si autoriteti kompetent dhe profesional sipas Ligjit të AD-së për të përcaktuar prioritetet dhe përmbajtjen e Programit trajnues për vitin 2023

6.2 Zhvillimi i veprimtarisë botuese

Komponentë e rëndësishme e PHP-së janë veprimtaria botuese dhe botimet e saj. Për fushën e botimeve është punuar ngushtë me ARF kompaninë kontraktuese të AD-së për shtyp dhe dizajn dhe është monitoruar procesi deri në finalizimin e tyre. Sipas kësaj kontrate janë realizuar 22 porosi, në kuadër të cilave janë botimet e moduleve trajnuese, programet dhe artikuj tjerë të planifikuar sipas kontratës. Në pajtim me kërkesat ligjore është vepruar në bazë të mjeteve të zotuar dhe Urdhër-blerjeve të lëshuara nga ana e Akademisë së Drejtësisë.

Në funksion të zbatimit të Programit të Trajnimit Fillestar për 48 gjyqtarët dhe 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX, PHP është angazhuar drejtpërdrejte në realizimin dhe shtypjen e moduleve trajnuese dhe Programit të PTF-së si në vijim:

- Moduli: Kodi Penal;
- Moduli: Kodi i Procedurës Penale;
- Moduli: Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
- Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale;
- Moduli: E drejta civile administrative dhe ekonomike;
- PTF për Gjyqtarët e sapo emëruar;
- PTF për prokurorët e sapo emëruar.

Për nevojat e zbatimit të trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive është rishtypur në sasinë prej 47 ekzemplarëve Moduli i Trajnimit bazik, aspekti penal- material dhe procedural si dhe Moduli bazik, aspekti civil-material dhe procedural.

Për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë publikuar botimet si në vijim:


- Plani i punës dhe i performancës për vitin 2023 i AD-së
- Raporti vjetor i AD-së për vitin 2021
- Programi i Trajnimit për vitin 2023

Është vazhduar përgatitja dhe publikimi i Buletinit informativ të AD-së me qëllim të njoftimit të të gjitha aktiviteteve të realizuara në baza mujore.

6.3 Pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, analiza e bazës së të dhënave dhe ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së

Programi i PHP-së ka qenë i angazhuar në ofrimin e burimeve ligjore sipas kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe përfituesve tjerë sipas ligjit. Në periudhën raportuese janë ofruar shërbime për qasje të materialeve ligjore që gjenden në data bazën e bibliotekës elektronike të AD-së. Kërkesat për materiale ligjore kanë qenë kryesisht në kategorinë e komentareve ligjor dhe doracakëve dhe kjo më tepër nga praktikantët, studentët dhe bashkëpunëtorët profesional e më pak nga gjyqtarët dhe prokurorët, meqenëse janë pajisë me formatet fizike shumë kohë më parë. Një pjesë e konsiderueshme e materialeve ligjore elektronike janë të publikuara edhe në faqen e AD-së.

Në mungesë të vegjlës për identifikimin e numrit të përdoruesve të bibliotekës elektronike ligjore në vijim gjendet numri i përdoruesve të faqes së AD-së që mund të jetë impakt edhe për bibliotekën.



Grafikoni nr. 6 Numri i përdoruesve të faqes së AD-së

Biblioteka ligjore e materialeve në kopje fizike në periudhën raportuese nuk ka qenë e kërkueshme prandaj edhe me zhvendosjen përkohësisht të AD-së në objektin e ri, kjo bibliotekë nuk është funksionalizuar. Mbetet në vijim për t'u vlerësuar funksionalizimi i saj varësisht prej dinamikës së kërkesave.

Me qëllim që përfituesve të saj t'iu ofrohen edhe resurse dhe burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë, AD ka vazhduar anëtarësimin në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike që konzorciumi i EIFL-as i siguron për vendet në tranzicion. Në këtë mënyrë gjatë vitit 2022 ka mundur për përfituesit e saj sipas ligjit dhe komunitetin tjetër ligjor qasjen në data bazat e natyrës ligjore dhe të përgjithshme si në vijim:

- **IOP science** që ka mundur studiuesit të hyjnë në përmbajtje shkencore, teknike dhe mjekësore.
- **Autoritetet shkencore të Oksfordit për të drejtën ndërkombëtare** e cila ka përfshirë traktatet autoritative, të cilat vazhdojnë definimin e fushave të tyre të së drejtës, punimet referuese dhe komentaret e Black-letter që ndihmojnë në përgjigjen ndaj disa pyetjeve

praktike të së drejtës dhe publikime të cilat ofrojnë këndvështrime inovative për problemet aktuale ligjore.

- **Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare** që ka ofruar artikuj enciklopedik lidhur me më shumë se 1600 çështje ligjore ndërkombëtare, koncepte dhe raste.
- **Publikimet Edward Elgar** që ka ofruar e-libra dhe revista të publikuara mbi ligjin, biznesin, ekonominë dhe shkencat sociale.
- **Revistat online të Cambridge** që ka ofruar qasje në koleksionin multi-diciplinor mbi 330 revista të cilat mbulojnë temat mbi shkencën, teknologjinë, mjekësinë, humanizmin dhe shkencat sociale.
- OECD-iLibrary e integruar për libra, revista, punime dhe statistika
- **eBiblioteka e Fondit Monetar Ndërkombëtar** – që ka siguruar qasje të fuqishme dhe të përshtatshme në internet për mbledhjen e plotë të përmbajtjes autoritative ekonomike globale të publikuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Me më shumë se 11,000 botime të tekstit dhe qasje të plotë tek bazat e të dhënave statistikore të FMN-së.
- **Baza Evropiane e të Dhënave të Jurisprudencës së të Drejtave të Njeriut për vendet e Evropës Juglindore.** Kjo data bazë ka ofruar vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përmbledhje të çështjeve të rëndësishme për rajonin në gjuhët lokale si dhe botime tjera si manuale dhe udhëzues të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Data bazat që ofron Asociacioni i Bibliotekave elektronike kanë periudhë të caktuar të qasjes dhe mund të zëvendësohen edhe me data baza tjera. Gjatë muajit dhjetor ky konzorcium ka ofruar mundësinë e abonimit edhe më tej të Cambridge Journals Online për të cilin AD ka aplikuar dhe është në pritje për qasje deri në fund të vitit 2023.

6.4 Përditësimi i statistikave dhe data bazës së të dhëna me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së

Njësia e statistikës është komponentë e rëndësishme e institucionit të AD-së dhe vepron në kuadër të PHP-së. Kjo njësi pas çdo trajnimit të realizuar në kuadër të programeve trajnuese të AD-së ka integruar të dhënat për të ftuarit dhe pjesëmarrësit në trajnime si dhe të dhënat nga formularët e vlerësimit nga pjesëmarrësit, trajnuesit dhe përgjegjësit e trajnimeve. Si rezultat i kësaj, data baza dhe statistikatat kanë vazhduar të jenë burimi kryesor i informatave për KGJK dhe KPK, për përfituesit e saj sipas ligjit si dhe grupet e tjera të interesit përkatësisht OJQ-ve në rast të kërkesave për çështje specifike për të cilat edhe këto organizata funksionojnë.

Kjo data bazë ka qenë në shërbim dhe në funksion të hartimit të raporteve për vijueshmërinë në trajnime dhe njoftimit për kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive në baza javore, në rastet e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në KGJK dhe KPK, për raportim në mekanizmat euro integruar dhe në ofrimin e të dhënave për përfaqësimin institucional në konferenca dhe takime të përbashkëta me institucione tjera të sistemit të drejtësisë.

Në periudhën raportuese data baza është zhvilluar edhe më tej duke mundësuar gjenerimin e të dhënave shumë saktë dhe shpejtë për çështje të rëndësishme në sferën e trajnimeve.

7. AVANCIMI DHE ZGJERIMI I BASHKËPUNITIT DHE KOORDINIMIT ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE

Si çdo vit me radhë, Akademia e Drejtësisë edhe në periudhën raportuese ka pasur në prioritet bashkëpunimin ndërkombëtar e në këtë rrafsh edhe asistencën dhe mbështetjen nga donatorët. Si rezultat i kësaj ka përfituar mbështetje në realizim të trajnimeve, punëtorive dhe tryezave të shumta si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe forume të ndryshme ndërkombëtare. Këto aktivitete kishin synim ngritjen e kapaciteteve profesionale në luftimin dhe parandalimin e dhunës në Familje, krimin të organizuar dhe korrupsionit, pastrimit të parave, fuqizimit të drejtësisë komerciale, mbrojtjes së të drejtave të njeiut si dhe zbatimin e praktikave më të mira në zgjidhjen e çështjeve ligjore përkatëse. Nga këto aktivitete kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe profesionistë tjerë ligjor. Këto aktivitete janë mbështetur nga Këshilli i Evropës, OPDAT -Ambasada Amerikane, zyra e BE-së në Prishtinë si dhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare që kanë në fokus mbështetjen e trajnimit gjyqësor. Në vijim për secilën nga këto bashkëpunime jepen detaje të hollësishme për numrin e aktiviteve dhe të dhëna tjera të rëndësishme.

7.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë është angazhuar intenzivisht në bashkëpunimin dhe koordinimin me KGJK dhe KPK për vlerësimin e nevojave trajnuese, zhvillimin dhe zbatimin e programeve trajnuese dhe për aspekte tjera me interes të përbashkët. Në funksion të kësaj ka arritur edhe një Marrëveshje të bashkëpunimit për zbatimin e Strategjisë për sundimin e ligjit. Në bashkëpunim me gjykatat dhe prokuroritë është bërë koordinimi për vijueshmërinë në trajnime.

7.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Akademia e Drejtësisë për të fuqizuar edhe më tej bashkëpunimin ndërinstitucional edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar në zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e sistemit të drejtësisë e po ashtu edhe me organizata që kanë fokus sundimin e ligjit. Vëmendje të veçantë Akademia e Drejtësisë i ka kuashtuar bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, përkatësisht grupin përgjegjës për zbatueshmërinë e Strategjisë për sundimin e ligjit dhe me koordinatorin nacional për Strategjinë për mbrojtjen nga mbrojtja nga dhuna në familje dhe dhunën ndaj grave.

7.3 Zbatimi i projekteve me donatorë

Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së OPDAT dhe Ambasadën Amerikane

Gjatë vitit 2022, si rezultat i bashkëpunimit me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, dhe Ambasadën Amerikane janë realizuar nëntëmbëdhjetë (19) aktivitete trajnuese të cilat kanë përfshirë tryeza, punëtori dhe trajnime. Nga këto aktivitete trajnuese tetë (8) ishin për Risitë e Kodit të Procedurës Penale, katër (4) punëtori për përmirësimin e praktikës gjyqësore ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve, për mjetet forenzike kibernetike, dy (2) trajnime për hetimet financiare, tri (3) trajnime për seancën e caktimit të dënimit, një (1) tryezë diskutimi me PSRK dhe gjyqtarët e departamentit special për zhvillimin e seancës efektive për caktimin e dënimit si dhe një (1) për zhvillimin e shkathtësive të përfaqësimit gjatë gjykimit.

Aktivitetet e realizuara me Projektin për Drejtësi Komercciale të mbështetura nga USAID

AD në bashkëpunim me Projektin për Drejtësi Komercciale– ka realizuar trembëdhjetë (13) aktivitete të cilat kanë përfshirë module trajnuese në fushën e drejtësisë komerciale. Në këto aktivitete trajnuese janë trajtuar çshtje nga ndërmjetësimi, nga pronësia intelektuale, markat tregtare dhe patenatat, arbitrazhi, specifikat e së drejtës fiskale, tatimore dhe doganore, instrumentet ndërkombëtare mbi çështjet fiskale dhe doganore, kontratat e ndërtimit, zgjidhja e mjeteve juridike në procedurën përmbarrimore dhe llogaridhënia e përmbarruesve privat, shoqëritë tregtare dhe për procedurën e falimentimit.

Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj

Me mbështetjen e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore ka realizuar trajnimin online me temë “Trajnim hyrës për ligjin dhe politikën e konkurrencës dhe rregullimin e ndihmës shtetërore në Kosovë”. Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të Ligjit të BE-së për konkurrencën dhe të Ligjit të BE-së për ndihmë shtetërore dhe zbatimin e tyre në Kosovë. Më pas janë diskutuar veq e veq karakteristikat kryesore të praktikave anti konkurruese dhe mënyra e rregullimit të tyre e gjithashtu edhe karakteristikat kryesore të procesit rregullues të ndihmës shtetërore.

Me projektin EUKOJUST janë realizuar pesë (5) aktivitete trajnuese të cilat ishin të orientuara në trajtimin e çështjeve ligjore si qasja në drejtësi për grupet e cënueshme-aspekti penal/civil, të drejtat e neriut dhe personat me nevoja të veçanta si dhe për akuzat dhe dënimet e rasteve të dhunës në familje.

Me projektin Mbështetja e BE-së për Sistemin e të Drejtave Pronësore Intelektuale në Kosovë) AD gjatë vitit 2022 ka realizuar dy (2) aktivitete trajnuese për zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me bazën ligjore dhe standardet ndërkombëtare të BE-së për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale për zgjidhjen e drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve në praktikën gjyqësore.

Me projektin e IRZ-së janë realizuar tri (3) aktivitete trajnuese me fokus te masat dhe dënimet që i shqiptohen të miturit, për të drejtën e insolvencës në shoqëritë tregtare si dhe në kuadër të Programeve të Specializuara- Pastrimi i parave dhe hetimi financiar-Sesionin e III. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur çështjet ligjore përkatëse.

Aktivitetet me Bankën Botërore - Projektin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO)

Me projektin e Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO) është realizuar një (1) trajnim i cili kishte në fokus angazhimin e fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara. Qëllimi i këtij trajnimi ishte gjykimimi i drejtë i përkatëse në praktikë nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Aktivitetet e realizuara me zyrën e Këshillit të Evropës dhe projektet e saj

Me projektin **I PROCEEDS** është realizuar trajnimi hyrës për gjyqtarët dhe prokurorët në fushën e Krimit Kibernetik dhe Provave Elektronike. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe zyrtarëve policor në ballafaqimin dhe trajtimin e rasteve të krimeve të kryera kundër ose nëpërmjet përdorimit të sistemeve kompjuterike.

Me projektin **JUFREX** janë realizuar gjashtë (6) aktivitete trajnuese për Lirinë e shprehjes dhe mediave të cilat janë dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Aktivitetet e realizuara me iniciativën e Chemonics për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), financuar nga Mbretëria e Bashkuar

Në periudhën raportuese, AD në bashkëpunim me projektin “Chemonics” ka realizuar procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese për krimin e rëndë dhe të organizuar. Janë realizuar takime të veçanta me Prokurorinë Speciale, Policinë e Kosovës si dhe me gjyqtarët e Departamentit Special. Qëllimi i këtyre takimeve ishte identifikimi i sfidave dhe vështirësive në trajtimin e rasteve të krimit të organizuar dhe adresimi i tyre përmes trajnimeve ose krijimit të manualeve ose udhëzuesve që do të konkretizojnë hapat dhe veprimet që duhet ndërmarrë akterët relevantë/zbatuesit e ligjit për zgjidhjen e drejtë të këtyre rasteve.

Gjithashtu përmes këtij projekti janë realizuar edhe dy (2) punëtori për Komisionet e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të KGJK-së dhe KPK-së të cilat kishin si qëllim hartimin e programeve trajnuese për anëtarët e këtyre komisioneve.

Aktivitetet e realizuara me OSBE-në

Në mbështetje të OSBE-së janë realizuar katër (4) aktivitete trajnuese, në të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial. Fushat në të cilat janë përqendruar aktivitetet përkatëse ishin për KEDNJ dhe Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht nenet 2 dhe 6 të kësaj konvente, për Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi dhe raporti i tij me Ligjin e punës dhe Ligjin për procedurën kontestimore si dhe për sigurimin e kërkesë padisë.

Aktivitetet e realizuara me GIZ

Për vite me radhë GIZ dhe projektet e saj kanë ndihmuar AD-në në fuqizimin dhe përmbushjen e mandatit të saj ligjor, përkatësisht në ofrimin dhe zbatimin e programeve trajnuese jo vetëm për gjyqtarë dhe prokurorë por edhe për profesionet e tjera të lira. Në periudhën raportuese, në bashkëpunim me GIZ janë realizuar gjashtë (6) aktivitete trajnuese. Në kaudër të këtyre aktiviteteve trajnuese janë trajtuar: Veprat penale kundër mjedisit, Patrimi i parave dhe hetimi financia, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në lëmine civile”. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të përfituesve sipas ligjit që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, të ngriten kapacitetet profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për zgjidhjen e drejtë të rasteve ligjore përkatëse.

Aktivitetet e realizuara me UNDP

Në periudhën raportuese, AD në bashkëpunim me UNDP ka realizuar dy (2) aktivitete trajnuese të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve si dhe profesionistëve tjerë ligjor për Rikuperimin e pasurive të vjedhura dhe hetimet financiare. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me Hetimet financiare dhe rikuperimin e aseteve për hetimin dhe gjykimin e rasteve të pastrimit të parave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Aktivitetet e realizuara me UNCHR-Zyra e Misionit në Kosovë

Gjatë vitit 2022 në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me UNCHR, është realizuar një (1) trajnim për gjyqtarët e departementit administrativ me temë: E drejta ndërkombëtare për refugjatët dhe personat me pa shtetësi. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e aftësive të gjyqtarëve në zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të azilkërkuesve, refugjateve edhe personave me pa shtetësi.

Aktivitetet e realizuara me Humanitarian Law Center dhe organizat tjera si INJECT, Qendra Kosovare për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës (KRCT) dhe Qendra Kosovare për studime gjonore

Në kuadër të bashkëpunimit me këto organizatë janë realizuar gjithësejt 5 aktivitete trajnuese. Me Humantirian Law Center Kosovo, është realizuar trajnimi me temë “Krimet luftës”. Me organizatën INJECT, trajnimi lidhur me Dispozitat ligjore në lidhje me pasurinë e përbashkët dhe mbajtjen financiare. Me Qendra Kosovare për rehabilitimin e të mbijetuarve të torturës (KRCT) është realizuar një trajnim për qasjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në sistemin e drejtësisë, ndërsa me Qendrën Kosovare për studime gjinore janë realizuar tri aktivitete trajnuese për Konventën e Stambollit me theks te forcimi i zbatimit në përfundim të dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

Aktivitetet e realizuara me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë

Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë. Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte fuqizimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë të Kosovës dhe Shkollës së Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë në lëmin e organizimit të aktiviteteve të përbashkëta për zhvillimin dhe avancimin cilësor profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe përfituesve tjerë ligjor të të dyja vendeve. Si rezultat i kësaj marrëveshje është realizuar një trajnim i përbashkët i gjyqtarëve nga të dy vendet me temë: Shkrimi dhe Arsytimi i vendimeve gjyqësore.

Aktivitetet e realizuara me EULEX

Në periudhën raportuese, AD në bashkëpunim me EULEX ka realizuar tri (3) aktivitete trajnuese në kuadër të cilave janë trajtuar aspekte me rëndësi për unifikimin e praktikave të prokurorisë, për ndryshimet në Kodin e Drejtësisë për të Mitur si dhe punëtori për mbrojtjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përfshirë në rastet e kundër korrupsionit. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte fuqizimi i kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjykimin e drejtë të rasteve duke zbatuar legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

Aktivitetet me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)

Në periudhën raportuese AD është njoftuar nga EJTN se projekti për Ballkanin Perëndimor pjesë e të cilit ka qenë edhe Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë edhe për tri vite me radhë. Ky projekt sipas udhëzimeve ka lehtësuar pjesëmarrjen në aktivitetet e EJTN-së kryetarëve të gjykatave, kryeprokurorëve, trajnuesve gjyqësorë dhe anëtarët e tjerë të gjyqësorit, të cilët mund të forcojnë me sukses lidhjet institucionale midis organizatës së tyre dhe kolegëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

Si rezultat i kësaj, Akademia e Drejtësisë ka mundësuar pjesëmarrjen e tre (3) gjyqtarëve nga Kosova në programin e shkëmbimeve të shkurta për vitin 2022 në institucionet e trajnimit gjyqësor si: Qendra e Trajnimit Gjyqësor në Letoni, Akademia e Trajnimit Gjyqësor në Lublin të Polonisë si dhe në Shkollën Nacionale të Gjyqësorit në Greqi.

Akademia e Drejtësisë përmes pikës kombëtare për EJTN ka marrë kërkesë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që t’ju mundësohet pjesëmarrja Këshilltarëve Ligjor në disa aktivitete për të cilat i ka financuar vet Gjykata Kushtetuese. Pas konsultimit me EJTN atyre ju është aprovuar pjesëmarrja në një (1) punëtori, një (1) seminar si dhe një (1) trajnim në të cilat

kanë përfituar gjashtë (6) Këshilltarë të Lartë Kushtetues-Juridik, një prej tyre Drejtor i Zyrës për Komunikim dhe Informim.

Për vitin 2023 janë bërë përgatitjet dhe përzgjedhja për Programin e Shkëmbimit për vitin 2023 për Kryetarë të Gjykatave, ku është bërë përzgjedhja e Kryetares së Gjykatës Themelore të Prishtinës, me financim nga Projekti i EJTN për Ballkanin Perëndimor II.

Po ashtu janë bërë nominimet për pjesëmarrje të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Programin e Vizitave Studimore për vitin 2023 me financim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Programet praktike dhe shkëmbimi i përvojave me vendet ne rajon

Programi praktik për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës në institucionet gjyqësore në Kosovë

Në vazhden e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës së Francës, përmes Ambasadës Franceze në Kosovë, në periudhën raportuese për dy kandidate nga kjo shkollë është organizuar programi praktik tre javor në institucionet gjyqësore në Kosovë. Kandidatet gjatë programit praktik paten mundësinë e njohjes me funksionimin e AD-së dhe programet e saj. Në vijim të këtij programi praktik ato janë njoftuar për së afërmi me punën në prokurori dhe gjykata kryesisht të nivelit themelor, si dhe kanë zhvilluar takime informuese edhe me bashkëpunëtorë vendorë dhe ndërkombëtarë të AD-së, varësisht prej temave të interesit të tyre.

Programi praktik i gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës në Bon

Në mbështetje të IRZ-së për gjyqtarët dhe prokurorët e gjeneratës së VIII që kanë përfunduar trajnimin fillestarë në Akademi të Drejtësisë gjatë vitit 2020-2021 është realizuar një vizitë studimore në Bon të Gjermanisë. Për shkak të numrit të madhë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kësaj gjenerate vizita është mundësuar në dy grupe. Grupi i I ka qenë në përbërje prej 13 prokurorëve dhe 5 gjyqtarëve, ndërkaq grupi II prej 19 gjyqtarëve këtë vizitë pritet ta realizoj në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vëzhgimi praktik i metodave të punës në Gjykatat dhe Prokuroritë e Shtetit Federal të Gjermanisë si dhe shkëmbimi i përvojave dhe fuqizimi i kontakteve ndërmjet institucioneve të dy vendeve. Për tri ditë me radhë gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës patën mundësinë e njohjes me rregullimin e sistemit gjyqësor në Gjermani dhe veçanërisht për drejtësinë penale, civile, familjare si dhe për mundësinë e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në Gjermani. Në kuadër të këtij programi janë njoftuar për së afërmi organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe prokurorive, kryesisht të shkallës së parë si dhe ndjekjen e dy seancave gjyqësore.

7.4 Planifikimi institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

Aktivitetet në mbështetje të mekanizmave integruar për BE

Akademia e Drejtësisë ka ofruar kontributin e saj në zbatimin e rekomandimeve dhe kërkesave nga dokumentet strategjike përmes hartimit të programeve trajnuese përshtatshme me prioritetet në Strategjinë për sundimin e ligjit, Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje, Programin Kombëtarë për të drejtat e njeriut, Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit si dhe Agjendën Evropiane dhe ka hartuar raporte të rregullta për raportim në mekanizmat përkatës të cilat më tej i kanë shërbyer edhe përgatitjes së inputeve për raportin e BE-së për Kosovën.

Kërkesat nga këto mekanizma dhe jo vetëm kanë ndikuar në volumin e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera të AD-së.

Bazuar në Strategjinë për sundimin e ligjit është realizuar përfshirja e shoqërisë civile në përcaktimin e kurrikulës trajnuese të AD-së për vitin 2023 e cila ka ndikuar në krijimin e perspektivave të reja për programin trajnues. Është zhvilluar vlerësimi i nevojave trajnuese për anëtarët e Komisionit për vlerësimin e performancës që veprojnë në kuadër të dy këshillave në KGJK dhe KPK si parakusht për zhvillimin dhe hartimin e programit trajnues për këto kategori. Aspekt tjetër me rëndësi është edhe krijimi i mekanizmit për matjen efektivit të trajnimit i cili ka filluar së zbatuari në gjashtëmujorin e dytë, përkatësisht në disa aktivitete trajnuese si dhe zbatimin e trajnimeve në fushën komerciale dhe një varg aktivitete tjera të cilat gjenden në progres dhe rezultatet priten edhe në vijim. Nga 48 masa të planifikuara, 21 prej tyre janë realizuar, 24 janë në proces e sipër dhe vetëm 3 prej tyre nuk ka pasur zhvillime.

Pjesë integrale e programit trajnues kanë qenë edhe aktivitetet sipas Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave me ç'rast janë realizuar ashtu siq janë paraparë me këtë strategji një mori aktivitete në luftimin e veprave penale të kësaj fushe duke përfshirë edhe aspektin civil. Të gjitha masat e planifikuara, 6 gjithësejt sipas kësaj strategjie janë realizuar.

Programi Kombëtar për të Drejtat e Njeriut po ashtu ka imponuar nurmin e madhe të aktiviteteve trajnuese në këtë fushë duke përfshirë edhe trajnime për mos diskriminimin, dhunën në familje dhe aspekte tjera të drejtave të njeriut. Si rezultat i kësaj ka pasur trajnime për nenet konkrete të KEDNJ-së dhe praktikën gjyqësore qoftë vendore ashtu edhe nga jurisprudenca e GJENDNJ-së e si dhe trajnimet që kanë qenë pothuajse të ngjashme me kërkesat nga Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje. Të gjitha masat e planifikuara, 7 gjithësejt janë realizuar.

Janë realizuar edhe një mori e trajnimeve të specializuara për pastrimin e parave dhe hetimin financiar duke përmbytur kështu përveq tjerash edhe kërkesat nga PKZMSA dhe Agjenda Evropiane (ERA).

Përveç mekanizmave euro integruar, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi ka bashkëpunuar me KGJK dhe KPK dhe njësitë për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime. Gjithashtu për nevojat e raportimit ose edhe të prezantimit institucional

në konferenca, takime dhe forma tjera janë nxjerrë të dhëna statistikore për aktivitetet trajnuese dhe detajet tjera që tregojnë angazhimin e Akademisë në ngritje të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit.

8. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Akademia ka vazhduar punën e saj duke bërë transparente veprimtarinë dhe aktivitetet e saj përmes portalit dhe web faqes. Në periudhën raportuese të gjitha aktivitetet e AD-së janë publikuar në faqen e saj duke filluar nga shpalljet dhe thirrjet për aktivitete të ndryshme, programet trajnuese, kalendarin e trajnimeve, njoftimet për realizimin e trajnimeve etj

9. ZBATIMI I POLITIKAVE ZHVILLIMORE TË DEPARTAMENTIT PËR ADMINISTRATË DHE FINANCA PËR MBËSHTETJEN E PROGRAMEVE TRAJNUESE DHE AKTIVITETEVE TJERA SIPAS LIGJIT NË FUQI

Departamenti i Administratës dhe Financave (më tej DAF) udhëhiqet nga Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili është nivel drejtues dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme si financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikes, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

Përgjegjësitë kryesore të DAF janë të përcaktuar me rregulloren për organizim të brendshëm dhe janë si në vijim:

- ✦ Përcaktimi i politikave dhe objektivave për zhvillimin dhe zbatimin e procedurave standarde në lidhje me buxhetin dhe financat, burimet njerëzore, prokurimin, teknologjinë informative, logjistikën dhe arkivin e Akademisë;
- ✦ Menaxhimi dhe koordinimi i procesit për ofrimin e shërbimeve administrative dhe financiare që kanë të bëjnë me funksionet dhe aktivitetet e Akademisë;
- ✦ Zhvillimin e një administrate profesionale, efikase, funksionale për ofrimin e shërbimeve administrative, në përputhje me nevojat dhe specifikat e Akademisë;
- ✦ Planifikimin, hartimin, raportimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin e buxhetit dhe financave të Akademisë;
- ✦ Zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë kompetencat e departamentit;
- ✦ Planifikimin, koordinimin dhe menaxhimin e aktivitetëve të prokurimit në Akademi në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi;
- ✦ Propozimin e akteve normative për funksionimin e departamentit;
- ✦ Planifikimin, mbikëqyrjen dhe administrimin me pajisjet e teknologjisë informative, programet softuerike dhe sistemet e rrjetit telekomunikues, të cilat janë pronë e Akademisë;
- ✦ Planifikimin, mbikëqyrjen dhe menaxhimin me pasurinë e Akademisë;
- ✦ Ofrimin e shërbimeve logjistike ku përfshihet furnizimi me mallra, shërbimet e transportit, mirëmbajtja e objektit dhe arkivi i Akademisë si dhe
- ✦ Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet relevante për zbatimin e legjislacionit në kuadër të funksioneve të departamentit.

9.1 Shërbimet e përgjithshme

Në kuadrin e shërbimeve të përgjithshme, në periudhën raportuese në aspektin administrativ, teknik dhe të logjistikës janë mbështetur të gjitha aktivitetet e organizuar nga AD. Varësisht nga aktivitetet trajnuese është bërë arkivimi i materialit trajnues për qëllime studimi. Gjithashu përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2021 dhe është publikuar raporti i auditimit si dhe përgatitur plani për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2021.

9.2 Zhvillimi, menaxhimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Të punësuarit në Akademi të Drejtësisë janë shërbyes civil dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave për shërbimin civil në Kosovë. Në pajtim me këto rregulla të punësuarit në Akademi janë në marrëdhënie pune me akt emërimi prej kur ka filluar të zbatohet ky sistem.

Stafi i AD-së është i angazhuar me zbatimin e programeve trajnuese, në analiza hulumtime dhe veprimtari botuese si dhe me shërbime tjera të cilat janë në funksion të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistë tjerë ligjor.

Numri i aprovuar i stafit me buxhetin e vitit 2021, ka qenë 32 pozita, ndërsa numri i stafit në fund të vitit ka qenë 25 zyrtar. Gjatë vitit 2022, një zyrtar ka dhënë dorëheqje. Pozitat e lira nuk kanë mundur të plotësohen për shkak të ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur gjatë vitit 2022.

Në funksion të zhvillimit të kapaciteteve të stafit, gjatë vitit 2022, në kuadër të IKAP kanë marrë pjesë në trajnime disa nga stafi i Akademisë për të cilat është përgatitur plani i trajnimeve, plani individual i punës nga të gjithë nëpunësit si dhe vlerësimi vjetor për arritjen e objektivave të punës.

9.2.1 Të punësuarit dhe nevojat për punëtorë të rinj

Në periudhën raportuese, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara sipas Ligjit Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022 ka qenë 32 pozita të karrierës.

Numri i aprovuar i stafit me buxhetin e vitit 2022, ka qenë 32 pozita, ndërsa numri i stafit në fund të vitit ka qenë 25 zyrtar.

Gjatë vitit 2022, një zyrtar ka dhënë dorëheqje nga puna. Nga gjithsej 32 pozita, 7 pozita janë të paplotësuara për shkak të problemeve me kolizionit të ligjeve. Pozitat e lira janë: 1. Koordinator i Programeve (udhëheqës i stafit administrativ), 2. Drejtor për Administratë dhe Financa, 3. Zyrtar i larë për përkthime, 4. Zyrtar i larë për përkthime 5. Zyrtar për personel; 6. Zyrtar për ekzekutim dhe përfaqësim dhe 7. Shofer/shtëpiak.

Pozitat e lira nuk kanë mundur të plotësohen për shkak të ndryshimeve ligjore që kanë ndodhur gjatë viteve 2020 - 2022. Në bazë të ligjit të AD, të punësuarit në AD kanë statusin e shërbyeseve civil, dhe organizimi i brendshëm i AD është rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të nxjerrë nga KD në vitin 2017 dhe e plotësuar në vitin 2018. Me hyrjen në fuqi të ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura i cili nuk ka përfshi Akademinë e Drejtësisë, ka pamundësuar rregullimin brendshëm ligjore të AD konform ligjit të lartpërmendur, e me këtë rast edhe statusin e të punësuarve në AD.

Me hyrjen në fuqi të Ligji për Zyrtaret Publik, dhe me pas me gjetjet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. ref.:AGJ 1583/20, i dt. 09 korrik 2020 në rastin nr.KO203/19 i cili ka obliguar Kuvendin sa i përket nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në diapozitiv të këtij Aktgjykimi, ku edhe pse nuk përmendet Akademia e Drejtësisë lenë mundësinë të interpretohet se AD renditet ne kuadër të institucioneve të pavarura të drejtësisë. Ndërsa iniciativa tashme e ndërmarr nga ish-Ministria e Administratës Publike, kurse tashëm Ministria e Punëve të Brendshme, vetëm se kishte iniciua procesin e racionalizimit të AD si agjenci e pavarur që do të zhvendosej nga Kuvendi tek Këshilli Gjyqësorë dhe Këshilli Prokurorial i Republikës së Kosovës.

Ndërsa gjatë vitit 2021 pas kërkesës së Akademisë së Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë tashmë kishte themeluar grupin punues për hartimin e koncept dokumentit për plotësim ndryshimin e ligjit të AD konform nevojave dhe kërkesave ligjore të AD-së, e që me këtë rast do të hapshin mundësinë edhe për organizmin e brendshëm ligjore të AD.

Gjithashtu ne vitin 2021 Këshilli Drejtues i AD ka nxjerr vendim me të cilin kërkohet nga gjitha institucionet relevante që të ndihmojnë rregullimin e statusit të punësuarve në AD përshtatshmërisht me statusin e të punësuarve në Sekretariatet e Këshillit Gjyqësorë dhe Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës.

Koncept dokumenti sikurse i lartpërmendur momentalisht është në konsultime publike dhe në muajit tetor pritet të finalizohet nga MD, ndërsa statusi i AD tashmë është rregulluar me ligjin LIGJI NR. 08/L-063 Ligj Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, respektivisht kapitulli IV i këtij ligji përcakton Akademinë e Drejtësisë si Institucion Publik i Pavarur në mbikëqyrje të plotë nga Këshilli Drejtues i AD. Pra plotësim ndryshimet e fundit të ligjit të AD hapin rrugën për rishikimin e te gjitha akteve nënligjore duke përfshi edhe Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, që mundëson siguri ligjore për plotësimin e pozitave të lira.

Me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor të Akademisë dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë planifikimit buxhetor për vitin 2023-2025 është ri përsëritur kërkesa për plotësimin e 11 pozitave të nevojshme për vitin 2023 si në vijim:

- ✦ Zyrtar (1) për Marrëdhënie me Publikun:
- ✦ Një (1) Udhëheqës për trajnime të stafit administrativ -
- ✦ Dy (2) Zyrtar të trajnimeve.
- ✦ Tre (3) Zyrtar për publikime dhe hulumtime
- ✦ Një (1) Zyrtar për shpenzime

Gjatë këtij viti Divizioni i TI-së ka vënë në përdorim pesë 5 smartboard – display interaktiv. Këta smartboard mundësojnë që trajneri dhe pjesëmarrësi të jenë bashkëpunues në një panel dixhital, të ndajnë materiale të ndryshme dhe të diskutojnë në grup edhe në një distancë të largët fizike;

Në dhjetor të këtij viti, për kohë të pacaktuar është ndërprerë shërbimi i komunikimit Skype for Business;

Gjatë këtij viti është bërë zhvendosje e stafit në një objekt tjetër. Në këtë rast Divizioni i TI-së ka bërë funksional rrjetin e internetit, rrjetin e telefonisë fikse si dhe secilin shërbim tjetër të TI-së në këtë objekt.

9.4 Prokurimi

Akademia e Drejtësisë ka hartuar planifikimin e prokurimit për vitin 2022 sipas ligjislacionit në fuqi si dhe në baze të kërkesave dhe nevojave vjetore nga të gjitha departamente e AD. Planifikimi i Prokurimit përfshinë kërkesat/nevojat e AD për punë/furnizime dhe shërbime në zhvillimin e aktiviteteve të AD. Me ndryshimin e Ligjit të Prokurimit zhvillimi i procedurave të prokurimit ka kaluar në kompetencë të Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Planifikimi i prokurimit përfshinë përshkrimin e punëve/furnizimeve dhe shërbimeve së bashku me vlerën e parashikuar.

Sipas ndryshimeve ligjore në fushën e prokurimit, AD si institucion me më pak se 50 nëpunës nuk ka të drejtë të zhvillojë procedura të prokurimit prandaj edhe të gjitha aktivitetet e prokurimit i ka realizuar përmes AQP-së.

Në periudhën raportuese aktivitetet e prokurimit të dërguara në AQP janë si në vijim:

- Furnizim me material higjienik;
- Furnizim me material zyrtar;
- Furnizim me inventar;
- Furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn (botime dhe publikime);
- Furnizim me naftë;
- Furnizim me artikuj ushqimor;
- DDD Dezinfektimi i objektit;
- Sigurimi fizik i objektit;
- Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit;
- Zhvendosja (bartja) e inventarit;
- Qasje dhe shfrytëzimi i platformës zoom.

Aktivitetet e prokurimit të realizuara janë si në vijim:

- Furnizim me karburante për vetura-lot 2;
- Furnizim me karburante për ngrohje dhe gjenerator-lot 4;
- Furnizim me materiale të shtypura-botime dhe publikime;
- Furnizim me material shpenzues për zyre- furnizim me letër;
- Furnizim me letër për kopje;
- Furnizimi dhe montimi i kontaktorit të gjeneratorit (pjesa elektrike);

- ✦ Një (1) zyrtar për mësim në distancë (e-learning)
- ✦ Dy (2) zyrtar ligjor

9.2.2 Trajnimet e stafit

Trajnimet janë një aspekt i rëndësishëm për zhvillimin profesional të çdo zyrtari publik prandaj edhe për stafin e Akademisë së Drejtësisë janë të domosdoshme trajnimet adekuate me funksionin dhe detyrat e punës. Në funksion të kësaj, Akademia ka qenë bashkëpunuese me IKAP-in dhe varësisht nga programi i ofruar ka përcaktuar stafin përfitues të cilët kanë marrë pjesë në këto trajnime. Gjithashtu Akademia ka përfshirë stafin edhe në trajnimet e organizuara në bashkëpunim me donatorë.

9.3 Avancimi i teknologjisë informative

Në periudhën raportuese teknologjia informarive ka qenë prioritet për Akademinë duke u fokusuar në aktivitetet si në vijim:

Mirëmbajtjen dhe administrimin e vazhdueshëm të pajisjeve të teknologjisë informative si kompjuterë, laptop, server, telefonia fikse dhe pajisjeve tjera;

Është mbështetur vazhdimisht stafi në procese të punës me çështjet që kanë të bëjnë me teknologji informative;

Është përgatitur plani ideor për projektin: “Blerja e pajisjeve të TI-së” dhe “Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese dhe ueb-faqes”. Që të dy këto plane janë aprovuar edhe nga ASHI;

Ueb faqja zyrtare dhe rrjetet tjera sociale të Akademisë vazhdimisht janë freskuar me informata të reja. Ueb faqja e Akademisë ka një numër të konsiderueshëm të vizitorëve. Gjatë këtij viti mesatarisht ueb faqen e kanë vizituar rreth 1550 përdorues për një muaj. Po ashtu edhe faqja e Akademisë në rrjetin social Facebook ka arrit në mbi 3340 ndjekës. Me ndërtimin e objektit të ri, është shtuar nevoja avancimit dhe furnizimit me pajisje të teknologjisë informative në sallat trajnuese të objektit me qëllim ngritjen e cilësisë së trajnimit dhe kapaciteteve trajnuese në AD. Pajisjet kryesisht përfshijnë pajisjet e përkthimit simultant, laptop, PC, projektor dhe smart board. Te gjitha këto pajisje pritet të kushtojnë rreth 500 mijë euro ku 300 mijë do të jenë donacion ndërsa 200 mijë do të jenë nga buxheti i AD-së;

Një pjesë e testit nga Programi i Trajnimit Fillestar për Gjeneratën e VIII të gjyqtarëve të sapo emëruar është organizuar në formë elektronike duke përdorur pajisjet elektronike. Divizioni i TI-së në Akademinë e Drejtësisë ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe ka ofruar mbështetje për mbarëvajtje të testimit;

Gjatë këtij viti janë zhvilluar dy kurse trajnuese në platformën e mësimin në distancë: këto kurse janë: Hetime Financiare dhe Rikuperimin e Aseteve dhe Mbajtja e Shënimeve për Përkthyesit e Gjykatave;

Ofrimi i qasjes për video komunikim-Zoom;
 Zhvendosja (bartja) e inventarit të Akademisë së Drejtësisë në objektin e ri. Me kërkesë dhe sipas planifikimit të prokurimit të Akademisë së Drejtësisë, Agjencia Qendrore e Prokurimit ka zhvilluar procedurën e prokurimit për zhvendosjen/bartjen e inventarit të AD. Akademia Drejtësisë ka kaluar në objekt të ri të marrur me qira;
 Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorit;
 Sigurimi i veturës;
 Furnizim me ujë të pijes;
 Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit-lot 3;
 Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor-Lot 4;
 Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor-Lot 5;
 Shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile.

9.5 Financat

Në kuadrin e financave janë realizuar aktivitetet si në vijim:

Janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare për vitin 2021;
 Është raportuar në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit të Kuvendit dhe në Komisionin për buxhet dhe Financa;
 Është përgatitur pyetësori për vetëvlerësim për vitin 2021;
 Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për vitin 2022;
 Është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Buxheti për periudhën 2023-2025 sipas të cilës kërkesa e Akademisë së Drejtësisë për vitin 2023 ka qenë 1,855,169 euro, ndërsa buxhet është ndarë nga MFPP në vlerë prej 892,367 euro.
 Janë bërë barazimet periodike të shpenzimeve me thesar;
 Janë përgatitur raporte të ndryshme (furnitor, mujore, vjetore) financiare;
 Të gjitha shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistruar në databazën e brendshme të financave dhe në SIMFK.

Shpenzimet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar si dhe nga mbështetja e granteve të donatorëve.

Shpenzimet e buxhetit përfshihen në këto kategori kryesore ekonomike: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale.

Tabela në vijim pasqyron buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2022 duke përfshirë kategoritë ekonomike.

Buxheti dhe Shpenzimet 2022				
Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Reduktimet dhe Kursimet Buxhetore	Buxheti Përfundimtar	Shpenzimet 2022
Pagat dhe Mëditjet	243,649.00	-	243,649.00	212,350.57
Mallrat dhe Shërbimet	400,000.00	-	400,000.00	269,210.26
Shpenzimet Komunale	16,500.00	-	16,500.00	7,180.89
Donacionet	-	-	27,007.11	24,607.11
Totali	660,149.00	-	687,156.11	513,348.83

Tabela nr. 12. Raporti i Buxhetit për vitin 2022

Me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, buxheti fillestar për këtë vit ka qenë 660,149.00 euro, për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzime komunale.


Totali i donacioneve të realizuare për vitin 2022 ka qenë 27,007.11 euro, nga JUFREX donacion janë 12,007.11 euro nga të cilat 4,227.11 janë bartje nga viti i 2021 dhe 7,780.00 euro janë donacion këtë vite,

nga UNDP janë realizuar këtë vit donacion prej 15,000.00 euro, ndërsa nga totali i donacioneve për këtë vite janë shpenzuar 24,607.11 euro dhe mbetje për vitin e ardhshëm janë 2,400.00 euro donacion i pa shpenzuar nga UNDP.

Buxheti përfundimtar për vitin 2022, në paga dhe mëditje është 243,649.00 euro, në mallra dhe shërbime 427,007.11 euro, prej të cilave 400,000.00 euro nga buxheti dhe 27,007.11 euro donacione dhe në shpenzime komunal 16,500.00 euro.


Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në % në raport me buxhetin total	Mbetja	Përqindja	Shpërndarja e buxhetit në %
Pagat dhe Mëditjet	243,649.00	212,549.68	36.41%	31,099	87	37
Mallrat dhe Shërbimet	400,000.00	363,593.05	62.28%	36,407	91	61
Shpenzimet Komunale	16,500.00	7,616.49	1.30%	8,884	46	2
Totali	660,149.00	583,759.22	100.00%	76,390	88	100

Tabela nr. 13. Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2022



Grafikoni nr. 7 Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2022


Nga buxheti përfundimtar janë shpenzuar 583,759.22 euro apo 88.44 % e buxhetit.



Grafikoni nr. 8 Shpërndarja e buxhetit

Sipas këtij grafikoni shihet se 37% e buxhetit përfundimtar është ndarë për paga dhe mëditje 61% për mallra dhe shërbime, dhe 2% për shpenzimet komunale.

Shpenzimet në % në raport me buxhetin total



Grafikoni nr. 9. Shpenzimi i buxhetit

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar: pagat dhe mëditjet me 36.41%, mallrat dhe shërbimet përfshihen me 62.28%, dhe shpenzimet komunale me 1.30%

Në tabelën në vazhdim përveç kategorive ekonomike shpenzimet prezantohen edhe për nënkategoritë ekonomike duke krahasuar me buxhetin e vitit për secilën nënkategori.

Shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive					
Shpenzimet janar - dhjetor 2022					
Numri i Llogarisë	Emri i Llogarisë	Shpenzimet	Buxheti	Ndryshimi	Përqindja
Paga					
11110	Pagat neto përmes listës	180,356.56	211,455.88	31,099.32	85.29
11500	Tatimi i ndaluar në të ardhura	11,950.14	11,950.14	-	100.00
11600	Kontributi i punëtorit	10,121.49	10,121.49	-	100.00
11700	Kontributi i punëdhënësit	10,121.49	10,121.49	-	100.00
Shuma		212,549.68	243,649.00	31,099.32	87.24
Mallra dhe Sherbime					
13132	A komodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-	1,000.00	1,000.00	-
13141	Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	4,212.56	7,000.00	2,787.44	60.18
13142	A komodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	-	3,000.00	3,000.00	-
13143	Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	642.12	1,000.00	357.88	64.21
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,301.14	3,360.00	1,058.86	68.49
13330	Shpenzimet postare	-	500.00	500.00	-
13410	Shërbimet e arsimit trajnimit	149,104.80	149,974.95	870.15	99.42
13430	Shërbime të ndryshme shëndetsore	-	300.00	300.00	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënës	3,069.45	4,000.00	930.55	76.74
13450	Sherbime shtypje-jo marketing	-	300.00	300.00	-
13460	Sherbime kontraktuese tjera	34,941.25	35,000.00	58.75	99.83
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	4,212.00	4,212.00	-	100.00
13509	Pajisje tjera	-	2,288.00	2,288.00	-
13610	Furnizime per zyre	2,586.67	9,948.20	7,361.53	26.00
13620	Furnizim me ushqim, pije (jo dreka zyrtare)	3,877.20	5,000.00	1,122.80	77.54
13640	Furnizime pastrimi	-	-	-	-
13720	Nafte per ngrohje qendrore	15,051.80	15,051.80	-	100.00
13770	Derivate per gjenerator	1,704.19	1,704.19	-	100.00
13780	Karburant per vetura	3,525.74	4,295.81	770.07	82.07
13951	Sigurimi i automjeteve	233.10	600.00	366.90	38.85
13952	Taksat Komunale e Regjistrimi te automjeteve	-	50.00	50.00	-
13953	Sigurim I ndertesave dhe tjera	12,167.98	12,167.98	-	100.00
13950	Regjistrim i automjeteve	118.00	300.00	182.00	39.33
14010	Mirembajtje dhe riparim i automjeteve	546.00	2,000.00	1,454.00	27.30
14020	Mirembajtje e ndertesave	7,979.96	7,979.96	-	100.00
14040	Mirembajtje e teknologjise informative	980.00	1,131.00	151.00	86.65
14050	Mirembajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	1,869.00	1,869.00	-	100.00
14110	Qiraja e ndertesave	81,317.13	81,317.13	-	100.00
14130	Qiraja per pajisjet	1,856.88	6,436.89	4,580.01	28.85
14140	Qiraja per makineri	15,583.15	15,583.15	-	100.00
14210	Reklamat dhe konkurset	-	1,000.00	1,000.00	-
14220	Botimet e publikimeve	9,926.03	12,991.94	3,065.91	76.40
14310	Dreka zyrtare	148.90	3,000.00	2,851.10	4.96
14310	Shpenzimet - Vendimet e Gjykatave	5,638.00	5,638.00	-	100.00
Shuma		363,593.05	400,000.00	36,406.95	90.90
Komunali					
13210	Rryma	4,669.58	8,000.00	3,330.42	58.37
13220	Uji	439.58	2,000.00	1,560.42	21.98
13230	Mbeturinat	694.35	2,300.00	1,605.65	30.19
13250	Shpenzimet e telefonit	1,812.98	4,200.00	2,387.02	43.17
Shuma		7,616.49	16,500.00	8,883.51	46.16
Totali		583,759.22	660,149.00	76,389.78	88.43

Tabela nr. 14. Shpenzimet për kategori dhe nën kategori ekonomik

Buxheti përfundimtar për vitet 2020 – 2022			
Përshkrimi	2020	2021	2022
Pagat dhe Mëditjet	219,038.08	212,350.58	243,649.00
Mallrat dhe Shërbimet	292,795.84	312,017.69	400,000.00
Shpenzimet Komunale	8,069.34	7,180.89	16,500.00
Shpenzime Kapitale	-	-	-
Totali	519,903.26	531,549.16	660,149.00

Tabela nr. 15. Krahasimi i buxhetit për vitet 2020 – 2022

9.6 Mbështetja financiare nga donatorët

Donacionet e menaxhuara nga AD

Viti	Emri i Donatori	Shpenzimet	Alokimi	Mbetja
2022	UNDP	12,600.00	15,000.00	2,400.00
2022	JUFREX	12,007.11	12,007.11	-
Shuma		24,607.11	27,007.11	2,400.00

Tabela nr. 16 Donacionet e menaxhuara nga AD

Shpenzimet e prezantuara në kuadër të këtij shënimit janë shpenzimet e krijuara me rastin e implementimit të projektit me UNDP dhe JUFREX.

Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2022 ka qenë 27,007.11 euro, nga JUFREX donacion janë 12,007.11 euro nga të cilat 4,227.11 janë bartje nga viti i 2021 dhe 7,780.00 euro janë donacion këtë vite, nga UNDP janë realizuar këtë vit donacion prej 15,000.00 euro, ndërsa nga totali i donacioneve për këtë vite janë shpenzuar 24,607.11 euro dhe mbetje për vitin e ardhshëm janë 2,400.00 euro donacion i pa shpenzuar nga UNDP.

			2022
Emri donatorit	Nr.i projektit	Emëri i projektit	Euro
GIZ			16,200.00
Humanitarian Law Center Kosovo			1,386.67
ILO			1,700.00
INJECT			2,737.00
iPROCEEDS-2			40,254.00
KE			82,000.00
OPDAT			65,618.99
UNHCR			570.00
WBROLI project			41,000.00
USAID			42,610.00
Totali i Granteve në euro			294,076.66

Tabela nr. 17. Donacionet e menaxhuara nga donatorët

Në tabelën 15 shpalosen donacionet e menaxhuara nga vet donatorët që do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së Thesarit.

Sipas informatave të ofruar nga përfaqësuesit e projekteve me donator në këtë tabelë bëhet shpalosja e mbështetjes financiare nga donatorët vetëm në totalin e shpenzimeve ashtu siç janë pranuar, pa pasur mundësi të shpalosen në detaje.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon qartë se AD edhe në këtë vit ka realizuar aktivitetet trajnuese në mbështetje të donatorëve të ndryshëm. Edhe pse nuk janë të specifikuar dhe të detajuara, shpenzimet e mbuluara kanë qenë kryesisht shpenzimet për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet për vizita studimore.

9.7 Asetet

Akademia mban në mënyrë të rregullt regjistrat e pasurisë. Regjistrimi i aseteve/pasurisë jo financiare bëhet në sistemin E-pasuri dhe SIMFK-së, varësisht nga blerjet e aseteve brenda vitit.

9.7.1 Asetet e Akademisë

Në kuadër të regjistratit të aseteve përfshihen pasuritë mbi 1,000 euro dhe pasuritë nën 1,000 euro. Në kuadër të regjistratit të pasurive mbi 1,000 euro janë të regjistruara automjetet, fotokopjet, pajisjet e teknologjisë informative dhe pajisjet e zërimit në vlerën neto prej 13,917.61 euro.

Ndërsa, pasuritë nën vlerën 1,000 euro bëjnë me pasuritë që kanë jetëgjatësi më shumë se një vit dhe përfshijnë kryesisht pajisje të teknologjisë informative, mobilie dhe inventar të ndryshëm, librat e bibliotekës etj.

Pasuritë jo financiare të Akademisë janë të gjitha pasuritë jo kapitale të regjistruara në E-pasuri. Në vlerën totale të pajisjeve përfshihet vlera e pajisjeve që disponon Akademia me 31 dhjetor 2022, 2022, vlera neto e aseteve nën 1,000 euro është 26,721.25 euro.

9.7.2 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë

Një ndër kërkesat më me rëndësi edhe për këtë vit është ndërtesa e Akademisë. Akademia që nga Dhjetori i vitit 2006 është e vendosur në një ndërtesë për të cilin është detyruar të paguaj qira, në mënyrë që të vazhdoj realizimin e funksioneve ligjore.

Si rezultat i ngecjeve dhe pengesave tjera që kanë dalë gjatë procesit të ndërtimit të objektit të AD-së, ka dështuar përfundimi i ndërtimit të objektit sipas kontratës për ndërtimin. Pronari i objektit me qira në të cilin Akademia ushtronte veprimtarë e saj është kërkuar të lirohet meqë planifikonte ndërtime të reja dhe kjo ka bërë që AD të kaloi në objekt të ri me qira e me këtë edhe lokacion të ri dhe kushte tjera të pagesës.

Hapësirat e ndërtesës së Akademisë, ku është tani janë rreth **2,000.00 m²**. Zbatimit i të gjitha programeve trajnuese, nevojat në rritje për trajnime të specializuara, nevojat për gjithë përfshirje në trajnime, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestar, trajnimi i profesionistëve tjerë të përcaktuar me ligj, krijimi i njësisë për hulumtime dhe bibliotekës, organizimi i konferencave dhe aktiviteteve tjera të ndryshme ka ndikuar që nevoja për hapësira të rritet.

Gjatë kohës së ndërtimit të objektit të Akademisë nga kompania ndërtuese, EUKOJUST ka angazhuar ekspert për përpilimin e specifikave teknike për riorganizimin e brendshëm të objektit si dhe specifikat teknike për teknologjinë informative. Eksperti i angazhuar së bashku me stafin e AD-së dhe stafin nga MPB-departamenti i inxhinieringut kan përfunduar këto specifikacione të cilat do të përdoren në kontratën e re për vazhdimin e punimeve në ndërtim të objektit deri në përfundim të tij.

9.8 Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2022 ka përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2021 dhe është publikuar raporti i auditimit. Raporti Final i Auditimit të pasqyrave financiare të AD-së për vitin 2021 ka rezultuar pozitiv dhe pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet kanë prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Me qellim të zbatimit të rekomandimeve të dala nga ky raport është përgatitur dhe zbatuar plani për rekomandimin e dhënë në lidhje me çështjet e gjetura gjatë vitit 2021.

Rekomandimet dhe plani i zbatim për implementim të rekomandimeve

Nr	Gjetja	Veprimi i ndërmarë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vlerësimi i rrezikut
1	Mos regjistrimi i pasurive në sistemin e-pasuria	Komunikimet e vazhdueshme me MPB për funksionalizimin e sitemit të e-pasurisë	Qershor - Dhjetor 2022		

Tabela nr. 18. Plan i zbatim të rekomandimeve

10. Sfidat dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2022, Akademia e Drejtësisë është përballë me sfida të shumta si në vijim:

- ✦ Procesi i rishikimit funksional që ka përfshirë edhe Akademinë e Drejtësisë;
- ✦ Buxheti jo i mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit;
- ✦ Staf i jo i mjaftueshëm në raport me kërkesat për programe trajnuese dhe aktivitete tjera sipas ligjit dhe strategjive;
- ✦ Mungesa e sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- ✦ Zhvendosja në lokacionin e ri të AD-së në kulmin e aktiviteteve trajnuese
- ✦ Mungesa e trajnuesve të profilizuar;
- ✦ Mungesa e literaturës dhe burimeve tjera për trajnime në gjuhën shqipe;
- ✦ Mungesa e programit të përhershëm për trajnues;
- ✦ Sigurimi i pjesëmarrjes në trajnime veçanërisht të atyre që hyjnë si rezultat i projekteve me partnerë ndërkombëtarë
- ✦ Zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të trajnimit veçanërisht të metodologjisë së trajnimit të bazuar në raste.

Për tejkalimin e sfidave të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë jep këto rekomandime:

Ligji i ri për AD të sigurojë pavarësinë institucionale dhe të adresojë mangësitë dhe pengesat ligjore që i ka ligji aktual në fuqi;

Rritja e buxhetit sipas nevojave dhe kërkesës buxhetore të dorëzuar në Ministrinë e Financave;

Rritja e numrit të punësuarve;

Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;

Planifikimi i përbashkët me KGJK dhe KPK me rastin e rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj

Hartimi dhe zbatimi i protokolleve të përbashkëta mes AD-së KGJK dhe KPK për zbatimin e trajnimeve të detyrueshme dhe trajnimeve shtesë në PTF si dhe për trajnimet bazike për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor;

Vënia në funksion e ndërtesës së re të AD-së e cila më pastaj ka impakt në buxhetin e AD-së.

Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2022

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
	Zbatimi i trajnimit praktik në gjykata për gjeneratën e VIII të 24 gjyqtarëve të sapo emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit si dhe në institucionet e tjera jo gjyqësore	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit praktik	Është hartuar Raporti përfundimtar për 24 gjyqtarët e sapo emëruar të cilët kanë përfunduar trajnimin praktik në fushën penale e me këtë edhe trajnimin fillestar në përgjithësi Raporti i është dërguar KGJK, përkatësisht Komisionit për vlerësimin e performancës

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
1. Aftësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar si dhe përgatitja profesionale përshtatshme rishit me rolin dhe detyrat e funksionit përkatës (realizimi i Programit të trajnimit fillestar)	Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve për gjeneratën e VIII të 24 gjyqtarëve të sapo emëruar në fushën hulumtuese dhe qasjen në burime ligjore	Monitorimi i zhvillimit të punimeve hulumtuese	Punimet hulumtuese të 24 gjyqtarëve të kësaj gjenerate janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga trajnuesit në PTF. Punimet hulumtuese i janë bashkangjitur dosjes dhe raportit përfundimtar për përfundim të trajnimit fillestar.
	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e radhës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.	Hartimi i programeve trajnuese për gjyqtarët/prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX Realizimi i trajnimeve fillestare ¹⁴	Programi është hartuar sipas afateve të përcaktuara duke iu përshtatur nevojave trajnuese për gjyqtarët dhe prokurorët e kësaj gjenerate. Prej 48 të dekretuarve nga radhët e gjyqtarëve për aspektin teorik janë trajnuar 45 ¹⁵ gjyqtarë. Prej 6 prokurorëve të dekretuar nga radhët e prokurorëve për modulet e trajnimit teorik dhe praktik gjatë kësaj periudhe janë trajnuar 5 ¹⁶ prokurorë
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionisteve të tjerë ligjor në shkathhtësitë dhe kompetencat profesionale dhe interdisciplinare	Zbatimi i trajnimeve cilësore të specializuara	Organizimi i trajnimeve për luftimin e krimeve të luftës, formave të korrupsionit dhe krimit të organizuar, krimit kibernetik si dhe dhunës në familje sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore	Nga 9 programe të specializuara të trajnimit, 124 gjyqtarë, 57 prokurorë, 13 bashkëpunëtorë profesional, 2 zyrtarë ligjor, 1 staf administrativ, 5 ekspert të PSRK-së, 10 zyrtarë policor, 1 ndërmjetësues, 7 zyrtarë nga SHSK janë trajnuar për luftimin e krimeve të luftës, formave të korrupsionit dhe krimit të organizuar, krimit kibernetik si dhe dhunës në familje
	Zbatimi i trajnime cilësore sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve;	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve profesionale sipas fushave	Nga 143 trajnime të realizuara, 235 gjyqtarë dhe 149 prokurorë të trajnuar në fushën penale 175 gjyqtarë dhe 3 prokurorë të trajnuar në fushën civile 34 gjyqtarë dhe 2 prokurorë të trajnuar në fushën administrative 31 gjyqtarë të trajnuar në drejtësinë për fëmijë aspekti civil 35 gjyqtarë dhe 26 prokurorë të trajnuar në drejtësinë për fëmijë aspekti penal 27 gjyqtarë dhe 1 prokuror të trajnuar për juridiksionin e DHPGJS 40 gjyqtarë dhe 2 prokuror të trajnuar për të drejtën ekonomike 155 gjyqtarë dhe 35 prokurorë të trajnuar për KEDNJ 27 gjyqtarë të trajnuar për fushën kundërvajtëse 9 gjyqtarë të trajnuar për gjyqësinë kushtetuese 16 gjyqtarë për fushën e ndërmjetësimit

¹⁵ 2 gjyqtarë nga radhët e minoritetit serb nga nëntori kanë dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit e me këtë rrjedhimisht kanë munguar edhe në trajnimin fillestar dhe 1 ka qenë në pushim të lehonisë

¹⁶ 1 prokurorë po ashtu ka kaluar në pushimin e lehonisë

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
	Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile	Organizimi dhe realizimi i tryezave	Janë realizuar 3 tryeza në fushën penale, 8 në civile, 6 ne drejtësinë për fëmijë (4 ne penale dhe 2 civile) si dhe 1 administrative
	Zbatimi i trajnimeve interdisciplinare për gjyqtarë dhe prokurorëve;	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve interdisciplinare	Nga 7 trajnime të realizuara në fushën interdisciplinare janë trajnuar 32 gjyqtarë dhe 8 prokurorë që kryesisht ishin për menaxhimin e stresit, instrumentet e CEPEJ që ka të bëjë me sistemin informativ të menaxhimit të rasteve si dhe për arsyetimin e vendimeve gjyqësore në fushën penale dhe civile
	Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	Organizimi i trajnimeve të detyrueshme sipas rregulloreve të KGJK-së dhe KPK-së Organizimi i trajnimeve të detyrueshme nga vlerësimi i performancës ¹⁷	Në periudhën raportuese trajnimet për risitë e KPPK-së kanë qenë obligative për të gjithë prandj edhe janë realizuar 8 trajnime për risitë e këtij Kodi Është hartuar dhe miratuar protokoli me KPK për trajnimet e detyrueshme për prokurorët me mandat të përhershëm. Pritet të zbatohet në rastin e kërkesave që dalin pas vlerësimit të performancës së prokurorëve. Ngjashëm pritet të vepohet edhe me KGJK-në për trajnimet e detyrueshme për gjyqtarë.
	Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesion	Hartimi i kalendarit, zhvillimi i moduleve si dhe realizimi i trajnimeve ¹⁸	Nuk ka pasur trajnime për avancim në profesion meqë këto trajnime vijnë si rezultat i kërkesave nga KGJK dhe KPK
	Zbatimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve nga modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor; Organizimi dhe realizimi i kurrikulës trajnuese të planifikuar sipas programit trajnues për vitin 2022 për stafin tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Prej 23 trajnimeve të realizuara 164 Bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të trajnuar për modulin bazik-aspekti penal material dhe procedural Prej 10 trajnimeve të realizuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë trajnuar 138 zyrtarë të cilët vijnë nga radhët e administratorëve, referentëve të lartë gjyqësor dhe nëpunës tjerë të gjykatave dhe prokurorive.
Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesioneve të lira	Zbatimi i trajnimeve për profesionet e lira	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	Nga 10 trajnime të realizuara për profesionet e lira kanë rezultuar 19 Përmbarues privat, 17 mbrojtës të viktimave dhe 28 zyrtarë të ANJF të trajnuar. Në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë edhe 101 avokatë kryesisht për Risitë e Kodit të Procedurës Penale

¹⁷ Periudha kohore e realizimit të trajnimeve të detyrueshme sipas rregulloreve dhe vlerësimit të performancës, numri i trajnimeve si dhe numri i pjesëmarrësve varet nga KGJK dhe KPK

¹⁸ Këto trajnime do të realizohen vetëm nëse paraqitet kërkesa nga KGJK dhe KPK.

Objekti i përgjithshëm	Nën objekti	Veprimi	Indikatori/Rezultati
Avancimi i metodologjisë trajnuese si pas standardeve dhe metodave bashkëkohore	Zhvillimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë	Hartimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë ¹⁹	Akademia e Drejtësisë në periudhën raportuese është angazhuar të zhvilloj programin trajnues të përhershëm për trajnues dhe mentorë i cili synonë ngritjen e aftësive dhe strategjive të mësimdhënies si dhe avancimin e teknikave për aplikimin e metodologjisë moderne trajnuese. Ky program është në proces të dizajnit dhe pritet të bëhet në bashkëpunim me OPDAT i cili do të mbështet me ekspertizë ndërkombëtare. Ky indikator nuk është arritur ende. Është në proces të realizimit me projektin OPDAT
